



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 21, datë 30.3.2018**

**Për**

**“Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 30.03.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”*

Dokumentacioni i Drejtorisë së Rregullimit Ekonomik dhe Statistikave përbëhet nga:

- i. Projekt vendimi;
- ii. Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;

- iii. Dokumenti: “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”;
- iv. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin.

### **BAZA LIGJORE:**

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
3. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010;
4. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2617-2620, datë 8.10.2015, të ndryshuara me VKD nr.2651, datë 03.12.2015;
5. Vendimin Nr.28, datë 27.12.2017, “*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse– Këshillim Publik*”.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

### **V Ë R E N:**

1. Këshilli Drejtus i AKEP me Vendimin Nr.28, datë 27.12.2017, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të Dokumentit “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse– Këshillim Publik*”.
2. Këshillimi publik u krye më datë 29.12.2017 – 28.02.2018, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente Autoriteti i Konkurrencës (AK) dhe operatorët Albtelecom, Telekom Albania dhe Vodafone Albania, nëpërmjet shkresave të mëposhtëme:
  - Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën nr. 11/1 prot., datë 21.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/4 prot., datë 26.02.2018);
  - Albtelecom sh.a me shkresën Nr. 1813 Prot., datë 28.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/5 prot., datë 28.02.2018);

- Vodafone Albania sh.a me shkresën ref. LEA/020/IL., datë 28.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/6 prot., datë 01.03.2018);
  - Telekom Albania sh.a me shkresën Nr. 1215, datë 15.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/3 prot., datë 21.02.2018).
3. Nga komentet e palëve të interesuara vihet re se AK është dakort me përfundimet e AKEP dhe masat e propozuara për rregullimin e tregjeve të telefonisë fikse shoqëruar me disa sugjerime, ndërsa operatorët në përgjithësi janë dakort me përfundimet e AKEP por kanë edhe qëndrime të ndryshme për disa aspekte të rregullimeve të propozuara nga AKEP. Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP për komentet janë paraqitur si Aneks i dokumentit përfundimtar të Analizës së Tregut.
4. Dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe Statistikave, përbëhet nga:
- Projekt-vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
  - Dokumenti *“Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”*, i cili përmban si Aneks 2: *Komentet në Konsultim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet*;
  - Komentet e palëve të interesuara për dokumentin *“Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse– Këshillim Publik”*;
  - Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD dhe dokumentin e Analizës së tregut.
5. Dokumenti *“Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”*:
- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 29.12.2017 – 28.02.2018, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
  - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë të të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
  - c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.9918/2008 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
  - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit

9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kriterëve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;

- e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
- f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

6. Dokumenti “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar*” përmban:

- përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuar;
- analizë e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT);
- masat rregulluese për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve në rrjetet fikse.

7. Dokumenti: “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar*”, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe masat rregulluese, kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë dokumentin “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Kundra ketij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas publikimit.
3. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

**ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Anila DENAJ**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**



**ANALIZË**  
**E TREGUT**  
**TË TELEFONISË FIKSE**

**Tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.**

**Dokument Final**

**Mars 2018**

*(Miratuar me VKD nr.21, datë 30.3.2018)*

## INDEKSI I PERMBAJTJES

<b>I. PERMBLEDHJE .....</b>	<b>4</b>
II.1 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PER PERCAKTIMIN E SIPERMARRSVE ME FNT .....	9
<i>Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator.....</i>	9
<i>Procesi i Këshillimit Publik .....</i>	10
<i>Analiza e tregut nga autoriteti rregullator dhe bashkepunimi me Autoritetin e Konkurrences .....</i>	11
<i>Perkufizimi i tregut perkates .....</i>	12
<i>Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese .....</i>	14
II.2 ANALIZA E TREGUT TE TELEFONISE FIKSE 2015 .....	15
<b>II. TREGU ME PAKICE I SHERBIMEVE TE TELEFONISE FIKSE.....</b>	<b>19</b>
III.1. NUMRI I PAJTIMTARËVE E TELEFONISË FIKSE .....	19
III.2 TRAFIKU TELEFONIK I PAJTIMTARËVE.....	21
III.3 TARIFIMI I SHERBIMEVE ME PAKICË TË RRJETEVE FIKSE.....	23
<i>Paketat e integruara ne rrjetet fikse.....</i>	24
<i>ARPM celulare.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
III.4. PERDORIMI MESATAR I THIRRJEVE TELEFONIKE FIKSE .....	26
III.5. PORTABILITETI I NUMRIT FIKS .....	27
III.6. FAKTORE TE TJERE KONKURRUES .....	28
III.7. PJESET E TREGUT DHE TREGUES FINANCIARE TË ALBTELECOM.....	29
<i>Pjesët e tregut.....</i>	29
<i>Tregues financiarë të Albtelecom.....</i>	30
III.8. PERFUNDIM MBI ECURINE E TREGUT TE TELEFONISE FIKSE .....	31
<b>IV. ANALIZA E TREGJEVE PERKATËS ME SHUMICE: TERMINIMI DHE TRANZITIMI I THIRRJEVE NE RRJETET FIKSE .....</b>	<b>32</b>
<i>IV.1. Perkufizimi i tregjeve te interkoneksionit .....</i>	32
IV.2. ANALIZA PER FNT E TREGJEVE TE INTERKONEKSIONIT .....	34
1. <i>Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse .....</i>	34
2. <i>Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse .....</i>	37
<b>V. MASAT RREGULLUESE PER OPERATORET ME FNT.....</b>	<b>40</b>
V.1. MASAT RREGULLATORE PER TREGJET ME SHUMICE TE INTERKONEKSIONIT .....	41
1. <i>Masat rregullatore per Albtelecom .....</i>	41
2. <i>Masat rregullatore per terminimin ne rrjetet e OA dhe Telekom Albania .....</i>	41
<b>ANEKS 1. LISTA E SIPERMARRSVE TE RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TE PROPOZUAR PER STATUS ME FNT NE TERMINIMIN E THIRRJEVE.....</b>	<b>43</b>
<b>ANEKS 2. LISTA E PYETJEVE PËR KËSHILLIM PUBLIK DHE KOMENTET E PALËVE TË INTERESUARA .....</b>	<b>45</b>

## INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

<i>Figura III.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonise fikse 2000-2016</i>	19
<i>Tabela III.1: Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2010-2016)</i>	20
<i>Tabela III.2: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse 2014- 2017 T3</i>	20
<i>Figura III.2. Norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe zonave urbane/Rurale (2016)</i>	21
<i>Figura III.3: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2010-2016</i>	22
<i>Tabela III.3: Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara</i>	24
<i>Tabela III.4 Numri i pajtimtarëve të Altelecom me shërbime të integruara(2013-2016)</i>	25
<i>Tabela III.5: Ecuria e ARPM per rrjete celulare 2010-2014</i>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<i>Tabela III.6: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike nga rrjet fiks i Altelecom 2010-2016</i>	26
<i>Tabela III.7: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2010-2016</i>	26
<i>Figura III.6: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2010-1017/T2)</i>	29
<i>Tabela III.3 Ecuria e Pjesevë të tregut të Altelecom 2008-2016</i>	30
<i>Tabela III.4: Tregues financiare te Altelecom</i>	30
<i>Figura IV.1: Skema e elementeve (inputeve) me shumice per realizimin e thirrjeve telefonike</i>	32
<i>Tabela IV.1: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Altelecom (2010-2018)</i>	36
<i>Tabela IV.2: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe Telekom Albania për Telekom Albania fiks (2010-2018)</i>	36
<i>Tabela IV.1 Pjeset e tregut te Altelecom Tranzitim thirrjesh kombetare (2014-2016)</i>	38



## I. PERMBLEDHJE

Ky dokument përbën dokumentin final të analizës e tregut të telefonisë fikse (tregjet përkatës me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse). Dokumenti përmban një rishikim të përfundimeve të analizës së fundit të tregut të telefonisë fikse të kryer në vitin 2015 dhe masave rregulluese përkatëse për FNT. Dokumenti i analizës së tregut trajton zhvillimet historike në treg dhe pritshmëritë e AKEP për të ardhmen e afërt dhe të mesme dhe masat rregulluese përkatëse për FNT në tregjet përkatës të analizuar.

Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (ne vijim Ligji 9918), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në Nenin 35 të tij ligji 9918 parashikon detyrimin për zhvillimin e procedurës së këshillimit me palët e interesit për analizën e tregut duke përcaktuar edhe kohëzgjatjen minimale të periudhës së konsultimit publik prej 60 ditësh.

Me vendimin nr. 28 të datës 27.12.2017 Këshilli Drejtues i AKEP vendosi të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse.

Procedura e këshillimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe masave rregulluese të propozuara për FNT, përfshirë rregullimin e tarifave me shumicë për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, është kryer për një periudhë 2 (dy muajore) dhe përfundoi me datë 28.02.2018.

Ky dokument final përmban:

- përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuar
- analizë e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT)
- masat rregulluese për sipërmarresit e vlerësuar me FNT.

Dokumenti final analizës është strukturuar si më poshte:

- Kapitulli I, Përmbledhje, përmban një përshkrim dhe përmbledhje të gjetjeve kryesore të dokumentit të analizës;
- Kapitulli II, Hyrje, përshkruan bazën ligjore dhe nen-ligjore për analizën e tregut dhe përfundimet e analizës së mëparshme të tregut të telefonisë fikse në vitin 2015;
- Kapitulli III përmban zhvillimet në tregun me pakicë të telefonisë fikse nga analiza e fundit e tregut;
- Në Kapitullin IV kryhet Analiza e tregjeve përkatës të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse
- Kapitulli V përmban masat rregulluese të propozuara për FNT(*masat për rregullimin e FTR do të pasqyrohen në një dokument të veçantë për konsultim publik*).
- Aneks 1 përmban listën e operatorëve të propozuar për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse
- Aneks 2 përmban pyetjet e këshillimit publik për këtë dokument, qëndrimet e palëve të interesuara dhe sqarimet e AKEP.

Ky proces i analizës së tregut që konkludohet me miratimin e versionit final të këtij dokumenti, përbën raundin e pestë të analizës së tregjeve të telefonisë fikse. Procesi i mëparshëm i analizës së tregut të telefonisë fikse në vitin 2015, përfundoi me publikimin e dokumentit final të Analizës së Tregut të Telefonisë Fikse dhe Vendimet e Keshillit Drejtues të AKEP, VKD nr.2617-2620, date 8.10.2015<sup>1</sup>, nëpërmjet të cilave vendosi ndër të tjera:

- Përcaktimin e Albtelecom sh.a. sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet fiks dhe tregun e tranzitimit të thirrjeve kombëtare në rrjete fikse dhe vendosjen e masave rregulluese;
- Përcaktimin e sipërmarrësve (operatorë alternativë) me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese;
- Përcaktimin e Telekom Albania sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fiks dhe vendosjen e masave rregulluese.

Masat rregulluese për FNT përfshinin midis të tjerave:

- Detyrime për mos-diskriminim dhe transparencë, përfshirë publikimin e RIO nga Albtelecom (për operatorët e tjerë nuk u vendos detyrim për RIO);
- Kontrollin e tarifave të Albtelecom për shërbimet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare;
- Kontrollin e tarifave për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet e operatorëve alternative si dhe të Telekom Albania për thirrjet drejt numrave gjeografike në rrjetin e vet.

Nëpërmjet procesit të analizës së tregut të vitit 2015 u vendos gjithashtu:

- De-rregullimi i tregjeve me pakicë të telefonisë fikse si tregje që nuk ishin më të justifikueshem për ndërhyrje ex-ante dhe heqja e statusit me FNT dhe masave rregulluese për Albtelecom në këto tregje;
- Reduktimi i segmenteve të terminimit nga 2 në 1 si dhe aplikimi i tarifave simetrike të terminimit të thirrjeve në rrjetin e Albtelecom dhe operatorëve të tjerë të rrjeteve fikse, si dhe reduktimi i pikave të interkoneksionit (POI) të Albtelecom nga 12 në 2 duke filluar nga 1.01.2018.

Ky dokument përmban analizën e tregut për tregjet përkatës të mëposhtëm:

- 1) Tregu me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;
- 2) Tregu me shumicë të shërbimeve të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.

Dokumenti përmban dhe një rishikim të ecurisë dhe zhvillimeve të tregut me pakicë të telefonisë fikse nga analiza e vitit 2015, efektet e rregullimit në tregjet fikse si dhe paraqet

---

<sup>1</sup> AKEP me VKD nr.2651, datë 3.12.2015, në kuadër të shqyrtimit të ankimit administrativ të Albtelecom kreu disa ndryshime në vendimet e datës 8.1.2015.

propozimet e AKEP për statusin me FNT dhe masat përkatëse rregulluese për tregjet e analizuara.

## **Konkluzione nga analiza e tregjeve me pakice**

Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 66 sipërmarrës të autorizuar, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP dhe marrëveshjeve të interkoneksionit të lidhura me Albtelcom rezulton se numri i operatorëve<sup>2</sup> që kanë raportuar të dhënat statistikore është rreth 42.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2016 arriti në rreth 249 mijë e cila krahasuar me vitin 2015(258 mijë), përbën një rënie me 2%. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2016 arriti në 8.8%, që është shumë më e ulët se rajoni i Europës (37.7%), dhe më e ulët edhe se mesatarja botërore (13.6%).

Gjatë dy viteve të fundit 2015-2016 ka vijuar trendi rënës i thirrjeve nga rrjetet fikse, dhe në vitin 2016 pajtimtarët e Albtelcom kryen 139 milion minuta thirrje që përbën një rënie me 27% në krahasim me vitin 2014. Megjithëse në vitin 2016 u vu re një rënie me 7% e thirrjeve nga rrjetet celulare në krahasim me vitin 2014, për shkak të rënies me ritme shumë më të shpejta të thirrjeve nga rrjetet fikse, këto të fundit përbënin vetëm 2.4% të totalit të thirrjeve të origjinuara nga rrjetet fikse dhe celulare në vitin 2016.

Vlerat e ARPM celulare tregojnë reduktimin e ndjeshëm të shpenzimit mesatar për një minutë thirrje nga rrjetet celulare, dhe ndonëse në vitin 2016 vihet re një rritje e saj, ajo është shumë e ulët në krahasim me ARPM mesatare të vendeve të BE (rreth 4.4 herë më e ulët) si dhe shumë e krahasueshme me tarifën për një minutë thirrje nga rrjetet fikse (jashtë paketave), duke cuar në zëvendësueshmëri të lartë për thirrjet nga rrjete fikse (sic vihet re dhe nga ecuria thirrjeve).

Mesatarisht për Albtelcom konsumi i thirrjeve të kryera në vitin 2016 ishte 65 minuta në muaj thirrje dalese si dhe 163 minuta në muaj thirrje të marra. Këto vlera janë 2.6 dhe 1.7 herë më të ulëta se konsumi mesatar i thirrjeve në rrjetet celulare në vitin 2016, duke cuar në rritje të hendekut të përdorimit mesatar të thirrjeve në krahasim me dy vite më parë (në vitin 2014 raporti përdorimit mesatar të thirrjeve nga rrjetet celulare me ato nga rrjeti fiks i Albtelcom ishte 2.1 dhe 1.3, respektivisht për thirrje dalëse dhe thirrje të marra).

Të dhënat statistikore dhe paketat/ofertat tarifore tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezulton të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

---

<sup>2</sup> AKEP gjithashtu është në fazën e evidentimit të sipërmarrësve që nuk ofrojnë informacionet statistikore sipas kërkesave ligjore.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kishin akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV) në fund të vitit 2016 arriti në rreth 187 mijë (nga 249 mijë abonente në total), rreth 25 % më shumë se në vitin 2015. Në vitin 2016 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 70% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 35% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Pjesa e tregut për pajtimtarë të telefonisë fikse e Albtelecom ka pasur rënie deri në fund të vitit 2015, ndërsa në periudhat e mëpasshme ka qenë e qëndrueshme në nivel rreth 71%. Megjithëse për thirrjet telefonike Albtelecom ka pjesë tregu të lartë prej 87%, pjesa e tregut në të ardhura totale nga rrjeti fiks është në nivel 60% dhe me rënie të ndjeshme me periudhat para vitit 2015.

Të ardhurat nga shërbimet e rrjetit fiks të Albtelecom kanë rënë me 15% në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë, e ndikuar kryesisht nga rënia e të ardhurave nga shërbimet me shumicë të interkoneksionit në rrjet fiks. Një impakt të konsiderueshëm në rënie e të ardhurave nga interkoneksioni ka rënia e ndjeshme e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkomëbater dhe të ardhurave të Albtelecom nga këto shërbime.

Bazuar në ecurinë e faktorëve të marrë në konsideratë në tregun e telefonisë dhe rrjeteve fikse, AKEP gjykon se nuk është e nevojshme që tregjet me pakicë të telefonisë fikse të jenë objekt rregullimi ex-ante, pasi faktorët që ndikuan në nxjerrjen nga rregullimi të këtyre tregjeve në vitin 2015 vijnë të jenë prezent dhe në disa raste dhe të jenë përforcuar.

## **Konkluzione nga Analiza e tregjeve me shumicë**

AKEP vlereson se:

- sipërmarresi Albtelecom sh.a vlerësohet se permbush kushtet për t'u shpallur me FNT në tregjet perkates te meposhtem:
  - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik Albtelecom të ofruar nga vendndodhje fikse;*
  - *Tregu me shumicë i shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombetare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse.*
- Sipërmarresi X i rrjetit alternativ X vlerësohet se permbush kushtet për t'u shpallur me FNT në tregun e shumicës të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e tij, konkretisht në tregun:
  - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të operatorit X të ofruar nga vendndodhje fikse.*
- Sipërmarresi Telekom Albania vlerësohet se permbush kushtet për t'u shpallur me FNT në tregun e shumicës të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e tij, konkretisht në tregun:
  - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjet publik telefonike Telekom Albania drejt numrave gjeografike të ofruara nga vendndodhje fikse (për pajtimtarët e Telekom Albania Fiks).*

AKEP konkludon të marrë masat rregullatore për FNT të Albtelecom për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombetare të ruajë detyrimet aktuale rregullatore të përcaktuara edhe në analizë 2015 si:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40);
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
4. Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45).

AKEP konkludon se operatorët alternativë të rrjeteve të telefonisë fikse plotësojnë kushtet për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale si dhe Telekom Albania për terminimin në numrat fiks në rrjetin celular Telekom Albania dhe për këtë arsye do të vijojnë të kenë detyrimete e përcaktuara në Analizë 2015:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40);
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
4. Detyrimi për kontroll tarife (neni 45).

AKEP, si edhe në analizat e mëparshme 2013 dhe 2015 gjykon që operatorët alternativë të mos kenë detyrim për publikim oferte referencë interkonesioni, pasi kjo masë nuk është e nevojshme dhe do të ishte jo-proporcionale.

**Sa i përket rregullimit të tarifave për FNT (FTR dhe tranzitim), do të ketë një dokument të veçantë pas miratimit të dokumentit përfundim të analizës së tregjeve përkatëse dhe marrjes së masave rregullatore.**

Procedura e këshillimit publik të jetë për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

## Hyrje

Ky dokument permban analizen e tregjeve me shumice te terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve ne rrjetet fikse. Dokumenti permban gjithashtu nje rishikim te perfundimeve te analizave se tregut te telefonise fikse te kryer ne vitin 2015 dhe masave rregulluese perkatese per FNT. Ne kete kapitull AKEP ka perfshire nje pershkrim te kuadrit ligjor dhe nen-ligjor per analizen e tregut si dhe te procesite te analizave se meparshme te telefonise fikse ne vitin 2015.

### **II.1 Kuadri ligjor dhe rregullator per percaktimin e sipermarresve me FNT**

Ky seksion permban informacion ne lidhje me kuadrin ligjor dhe nen-ligjor per analizen e tregut, rolin e analizave se tregut dhe masave rregulluese, konceptin e dominances/FNT dhe lidhjet midis rregullimit ex-ante nga rregullatori sektorial dhe atij ex-post nga autoriteti i konkurrences.

#### **Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator**

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, (ne vijim Ligji 9918), ne nenin 1 te tij, percakton se qellimi i ligjit eshte qe nepermjet parimit te asnjansise teknologjike te promovojë konkurrencen dhe infrastrukturë efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave se AKEP nxit konkurrencen efçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e analizave se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja), dhe me Vendimin nr.2342, date 31.07.2013 ka miratuar amendime te kesaj Rregulloreje. Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 7 tregje per t’u analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimin per te kryer testin e tre kriterave per tregjet qe nuk jane pjese e listes se tregjeve te rregullores ose e Rekomandimit ne fuqi te Komisionit European per tregjet perkatese te dyshuara per nderhyrje ex-ante ne sektorin e komunikimeve elektronike. Lista e tregjeve te perfshira ne rregullore

është sipas rekomandimit të KE të vitit 2007, ndërsa rekomandimi i fundit në fuqi i KE është Rekomandimi 2014/710/EC i datës 9 Tetor 2014.

Ligji 9918 është në linjë me direktivat e KE të vitit 2003 dhe 2009 dhe metodologjia e analizës së tregjeve të përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Europian dhe BEREC. Disa nga Rekomandimet dhe udhëzimet e KE dhe BEREC (me parë ERG) të marra në konsideratë nga AKEP në përgatitjen e këtij dokumenti janë si më poshtë:

- Udhëzimi i Komisionit (Europian) për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)<sup>3</sup>;
- Dokumenti i rishikuar i ERG<sup>4</sup> për Qendrim të përbashkët në qasjen ndaj masave rregulatore të duhura në kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike;
- Rekomandimi i Komisionit, datë 9 Tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara ex ante në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC);
- Rekomandimi i Komisionit, datë 7 Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjete celulare dhe fikse në BE;
- Dokumenta të tjera të KE dhe BEREC sipas shënimeve përkatëse.

## Procesi i Këshillimit Publik

Ligji Nr.9918, parashikon në Nenin 35 të tij, procedurën e këshillimit me paletë e interesit për analizën e tregut duke vendosur si afat një periudhë kohore prej 60 ditësh. Njëkohësisht neni 36 përcakton se AKEP vendos, ndryshon, mban ose heq detyrime për FNT pas këshillimit me palët e interesuara.

Me vendimin nr. 28 të datës 27.12.2017 Këshilli Drejtues i Akep vendosi të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse.

Dokumenti përmbante perkufizimin e tregut përkatës, analizën për FNT dhe masat rregulluese të propozuara për FNT si mos-diskriminimi, transparencë, etj, përfshirë detyrimin e kontrollit të tarifës.

Për dokumentin e analizës së tregut i nxjerre në këshillim publik përmbante përveç të tjerave propozimet e AKEP për masat rregulluese/detyrimet për FNT, të cilat konkludohen me miratimin e dokumentit final të analizës ndërkohë që sa i përket rregullimit të tarifave për

---

<sup>3</sup> Official Journal of the European Communities C 165/7: “Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services (2002/C 165/03)”

<sup>4</sup>ERG (06) 33 “Revised ERG Common Position on the approach to appropriate remedies in the ECNS regulatory framework” Final Version May 2006.



FNT (FTR dhe tranzitim), do të ketë një dokument të veçantë pas miratimit të dokumentit përfundim të analizës së tregjeve përkatëse dhe marrjes së masave rregullatore.

Procedura e këshillimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe masave rregulluese të propozuara për FNT, përfshirë rregullimin e tarifave me shumicë për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, është kryer për një periudhë 2 (dy muajore) dhe përfundoi me datë 28.02.2018.

## **Analiza e tregut nga autoriteti rregullator dhe bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës**

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918, AKEP-i duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK) kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi ku midis të tjerave “Neni 6”, parashikon bashkëpunimin midis dy autoriteteve për perfuzimin e tregut, përcaktimin e dominancës/FNT, masave rregulluese etj. Ky dokument paralelisht i dërgohet edhe AK për dhenien e komenteve përkatëse.

Siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nën-ligjore të komunikimeve elektronike në Shqipëri dhe dokumentat e KE dhe BEREC, roli i analizës së tregut është të përcaktojë nëse tregu/tregjet përkatës të analizuar janë apo tentojnë të shkojnë drejt konkurrencës efektive dhe në rast se jo përcaktimin e operatorit/operatorëve me FNT dhe masat rregulluese në tregun/tregjet përkatëse që çojnë në konkurrencë efektive.

Analiza e tregut bazohet fillimisht në një listë të tregjeve përkatëse që janë të justifikueshme/dyshuar për nderhyrje ex-ante, dhe bazuar në parimet/kriteret e përcaktuara për gjetjen e dominancës sipas parimeve të legjislationit për konkurrencën përcaktohet operatori/operatorët me FNT në treg.

Megjithatë analiza e tregut rregullator sektorial bazohet në parimet e konkurrencës, roli i saj është i ndryshëm nga analizat e AK për dominancë dhe abuzim me dominancën. Analiza e tregut e rregullatorit sektorial bazohet në të kaluarën, por vlerëson dhe perspektivën e tregut dhe mundësitë për FNT në të ardhmen dhe merr masa në rast se vlerësohet se do ketë dominancë në të ardhmen, pra nderhyrje ex-ante për të eliminuar problemet që mund të ndodhin në treg nga dominanca.

Ndërsa, AK në rastet e vlersimit të abuzimit me dominancën merr në konsideratë sjelljen dhe demin që mund të ketë shkaktuar dominancë e një operatori në treg në të kaluarën. Pra problemet që mund të kenë ndodhur nga sjellja abuzive në një treg të caktuar në të kaluarën, adresohen nga ligji dhe nderhyrjet e AK.

Udhëzimi i KE për analizen e tregjeve paraqet në mënyrë më të detajuar ngjashmeritë dhe ndryshimet midis analizave të kryera nga rregullatori i komunikimeve elektronike në lidhje me perfuzimin e tregut përkatës dhe dominancës dhe ato të kryera nga autoriteti i konkurrencës për abuzim me dominancë apo vlerësime të bashkimeve të kompanive.



Ne paragrafet 30<sup>5</sup> dhe 31<sup>6</sup> te ketij udhezimi KE citon nder te tjera se percaktimi me FNT i nje sipermarresi ne rregullimin ex-ante nuk nenkupton automatikisht se ai eshte me pozite dominuese apo qe ka abuzuar me poziten dominuese sipas legjislacionit te konkurrences, si dhe ne praktike mund te ndodhe qe dy autoritetet (rregullatore dhe i konkurrences) te kryejne procedura paralele per te adresuar probleme te ndryshme ne tregjet perkates.

Megjithate, KE thekson se ne te tilla raste detyrimet ex-ante te rregullatorit per FNT synojne te permbushin objektivat e direktivave (ligjit) ndersa masat e Autoritetit te Konkurrences synojne te sanksionojne marreveshje ose sjellje abuzive te cilat kufizojne ose shtremberojne konkurrencen.

### **Komentet e Autoritetit të Konkurrencës<sup>7</sup>**

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.11/1, datë 21.02.2018, i bëri me dije AKEP se Komisioni i Konkurrences në mbledhjen e datës 20.02.2018 mori në shqyrtim dokumentin "Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitirnit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Keshillim Publik", të miratuar me vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP Nr. 28, date 27.12.2017. Komentet e AK janë paraqitur në Ankes 2 të këtij dokumenti

### **Perkufizimi i tregut perkates**

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtis treg.

---

<sup>5</sup> *The designation of an undertaking as having SMP in a market identified for the purpose of ex-ante regulation does not automatically imply that this undertaking is also dominant for the purpose of Article 82 EC Treaty or similar national provisions. Moreover, the SMP designation has no bearing on whether that undertaking has committed an abuse of a dominant position within the meaning of Article 82 of the EC Treaty or national competition laws. It merely implies that, from a structural perspective, and in the short to medium term, the operator has and will have, on the relevant market identified, sufficient market power to behave to an appreciable extent independently of competitors, customers, and ultimately consumers, and this, solely for purposes of Article 14 of the framework Directive.*

<sup>6</sup> *In practice, it cannot be excluded that parallel procedures under ex-ante regulation and competition law may arise with respect to different kinds of problems in relevant markets (15). Competition authorities may therefore carry out their own market analysis and impose appropriate competition law remedies alongside any sector specific measures applied by NRAs. However, it must be noted that such simultaneous application of remedies by different regulators could address different problems in such markets. Ex-ante obligations imposed by NRAs on undertakings with SMP aim to fulfil the specific objectives set out in the relevant directives, whereas competition law remedies aim to sanction agreements or abusive behaviour which restrict or distort competition in the relevant market.*

<sup>7</sup> Komentet e plota te Autoritetit te Konkurrences dhe sqarimet perkatese te AKEP jane ne aneksin bashkelidhur.

Sic eshte cituar ne Analizat e tregut te meparshme AKEP ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates, perdor perkufizimin e dhene ne nenin 3, pika 7 te Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar:

***Treg perkates-*** jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatoret ose klientet e tyre, per sa u perket karakteristikave, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrence, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.

Ky perkufizim i Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar, eshte i ngjashem dhe ne linje me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44<sup>8</sup>, udhezim i perdorur nga AKEP (ERT) ne te gjitha analizat e meparshme. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore per analizen e tregut, AKEP ne kete Analize perdor te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analizat e tjera te tregut, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje produkt/sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit/sherbimit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

#### ***Parimi i monopolistit hipotetik***

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimpruese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimpruese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses- konsumatoret do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjetër, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

#### ***Zevendesimi ne anen e kerkeses***

---

<sup>8</sup> According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

*Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorët te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?*

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorët mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

### ***Zevendesimi ne anen e ofertes***

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi. Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatore, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrencës se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne tarifimin e sherbimeve te ndryshme: s'ka mundesi te rrise çmimin e nje sherbimi pa reduktuar çmimin e nje sherbimi tjetër, i cili ne vetevete nuk eshte zevendesues per sherbimin tjetër.

### **Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese**

Pekufizimi i FNT eshte dhene ne nenin 33 te ligjit:

*Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.*

Ky perkufizimi eshte pothuajse i njejte me perkufizimin e Direktives Kuader te KE 2002, neni 14<sup>9</sup> (EC 2002 Framework Directive).

---

<sup>9</sup> *'an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers'*

Neni 33 i Ligjit përcakton gjithashtu kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrje me FNT, që do të thotë dominancë individuale, dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrje me FNT apo dominancë e bashkuar. Përkufizimi i dominancës së bashkuar i dhënë në nenin 33 është si vijon:

*Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cilatë çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.*

Për përcaktimin e FNT, dominancë individuale apo e bashkuar, siç theksohet dhe në pikat 79 dhe 98 të Udhezimit të KE, kriteret e përdorur duhen marrë të gjithë në konsideratë dhe në kombinim me njëri tjetrin dhe jo në mënyrë të veçantë për secilin kriter me vetë, pasi evidencat e kriterëve të veçantë mund të mos jete përcaktuese e FNT.

Analiza për FNT është një analizë e cila merr në konsideratë zhvillimet e kaluara dhe njëkohësisht tendencën për të ardhmen (forëard looking), pasi mungesa e konkurrencës në të kaluarën nuk do të thotë që një treg nuk ka tendencë për të qenë në konkurrencë në të ardhmen. Në këtë mënyrë Analiza krahas shqyrtimit të kriterëve për vlerësimin e konkurrencës efektive në treg në të kaluarën, bën vlerësimin se si pritet të evoluojë tregu në të ardhmen. Analiza kryhet për të shqyrtuar nëse një treg përket vlerësohet të jete në konkurrencë efektive në një periudhë të paktën 2 vjetore, dhe mungesa e konkurrencës efektive në një treg përket të justifikueshëm për nderhyrje ex-ante është e barazvlefshme me ekzistencën e fuqisë së ndjeshme në treg, prej një ose më shumë sipërmarrësish.

Ekzistenca e FNT do të thotë që në treg ka probleme të cilat identifikohen dhe në bazë të problemeve të evidentuara, propozohet marrja masive rregulluese apo detyrimeve për tu zbatuar nga sipërmarrësi/sipërmarrësit me FNT. AKEP në bazë të nenit 34, ka detyrimin që në rast të gjetjes së FNT në një treg përket të vendosë një disa apo të gjitha detyrimet e cilesuara në nenet 39-45 dhe neni 56 të Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masive rregulluese për FNT duhet të marrë në konsideratë objektivat rregullatore të përcaktuara në Ligj.

Nëse nga analiza arrihet në përfundimin se tregu përket është në konkurrencë efektive, pra nuk ka FNT, atëherë AKEP nuk vendos detyrime dhe në rast se ndaj sipërmarrësve janë vendosur detyrime (për shkak të statusit të meparshëm me FNT) atëherë AKEP i heq këto detyrime duke përcaktuar dhe një afat kohor jo më të gjatë se 6 muaj për berjen efektive të tyre. Ky përcaktim aplikohet edhe për tregjet e analizuar, por që nuk përmbushin testin e tre kriterëve për nevojën për nderhyrje ex-ante.

## **II.2 Analiza e tregut të telefonisë fikse 2015**

AKEP bazuar në Ligjin 9918 (nenet 31 e në vijim, të Kreut VI mbi Rregullimin e konkurrencës), Rregulloren për Analizën e Tregut<sup>10</sup>, gjatë vitit 2015 kreu procedurën e

---

<sup>10</sup>“Rregullore për Analizën e Tregut” miratuar me Vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, të Këshillit Drejtues të AKEP, ndryshuar me VKD nr.2342, datë 31.07.2013.

analizës së tregut të telefonisë fikse, në përfundim të së cilës u miratuan vendimet e mëposhtme:

1. Vendimi nr. 2617, datë 8.10.2015, për *“Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit-Dokumenti përfundimtar”*;
2. Vendimi nr. 2618, datë 8.10.2015, për *“Përcaktimin e sipërmarrësve<sup>11</sup> me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”*;
3. Vendimi nr. 2619, datë 8.10.2015, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse”*;
4. Vendimi nr. 2620, datë 8.10.2015, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fikse<sup>12</sup> dhe vendosjen e masave rregulluese”*.

Vendimet e mësipërme të AKEP përmbanin:

- Përcaktimin e **Altelecom sh.a. sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet fikse dhe tregun e tranzitimit të thirrjeve kombëtare në rrjete fikse** dhe vendosjen e masave rregulluese,
- Përcaktimin e **80 sipërmarrësve (operatorë alternativë) me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse** dhe vendosjen e masave rregulluese,
- Përcaktimin e **Telekom Albania sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania** drejt numrave gjeografikë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese.

Në lidhje me statusin e FNT të Altelecom për terminim dhe tranzitimin e thirrjeve, AKEP në vitin 2015 vendosi detyrimet e mëposhtme:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);
- Detyrimi i transparencës, përfshirë publikim të RIO (Neni 40);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
- Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45).

Masat rregulluese ndaj operatorëve Alternativë dhe të Telekom Albania (Telekom Albania fikse) për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre në vitin 2015 janë:

---

<sup>11</sup> Sipërmarrësit e shpallur me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë dhënë në Listë në Aneks 1 të këtij Vendimi

<sup>12</sup> Shërbimi telefonik GSM Fiks i tregtuar si Telekom Albania Fiks

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);
- Detyrimi i transparencës (Neni 40);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
- Detyrimi për kontroll tarife (neni 45).

*Detyrimet për këta operatorë nuk përfshijnë publikim të RIO-s, si dhe një sërë detyrimesh të tjera të vendosura ndaj Albtelecom. Detyrimi i kontrollit të tarifës përfshin rregullimin nga AKEP të tarifave të terminimit të operatorëve alternativë.*

Në lidhje **me tarifatat e terminimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom, 80 OA dhe Telekom Albania**, AKEP vendosi:

- Nga data 1.01.2016 të reduktohet numri i segmenteve të tarifimit të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse nga 2 në 1, si dhe të eliminohet asimetria e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të operatorëve alternativë me tarifatat e terminimit në rrjetin Albtelecom;
- Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, tarifa e tranzitimit dhe numri i pikave të interkoneksionit (POI) në rrjetin Albtelecom të reduktohen sipas vlerave dhe afateve në tabelën e mëposhtme:

	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018
<b>Albtelecom terminim:</b>				
Lokal/Njëfish	1.19	1.48	1.29	0.70
Dyfish	1.85			
Nr.POI	12	12	12	2
<b>Albtelecom transit kombetar:</b>	1.32	0.93	0.81	0.44
<b>80 OA Terminimi</b>				
Lokal	1.34	1.48	1.29	0.70
Mesatare-Njëfish/dyfish	1.77			
<b>Telekom Albania</b>				
Terminimi GSM Fiks	1.19	1.48	1.29	0.70

*Shënim: Tarifatat në lek/minutë pa TVSH*

Ne analizen e vitit 2015 AKEP gjykoj se reduktimi i pikave të interkoneksionit të Albtelecom në 1.01.2018, nga 12 në 2, krijon kohë të mjaftueshme për OA për përshtatje me zhvillimet e fundit dhe investimet e Albtelecom (rrjeti NGN/NGA), duke krijuar njëkohësisht stimuj për Albtelecom për vazhdimin e investimeve në modernizim të rrjetit fikse që duhet të sjellë përfitime për gjithë tregun në tërësi, sidomos për përdoruesit fundorë.

AKEP në Analizën e tregut fikse 2015 gjithashtu vendosi de-rregullimin (heqjen e statusit me FNT dhe masave rregulluese për FNT të Albtelecom) të tregjeve më pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse si dhe të tregut me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetet fikse. AKEP arriti në këtë përfundim bazuar në zhvillimet e tregut të telefonise fikse dhe të tregut të komunikimeve elektronike në teresi në Shqipëri, rekomandimet e KE për tregjet perkates dhe pervojat në vendet e BE-se, ku ndër më të rëndësishmet janë:

- Shumica e ofruesve të thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse zoterojne rrjetin e tyre të aksesit për lidhje me përdoruesin fundor. Në Shqipëri janë rreth 80 operatore alternative që zoterojne rrjetin e vet të aksesit (kryesisht me linja bakri në rrjetin e aksesit por edhe me kabllor koaksial dhe pa tela si p.sh. Telekom Albania) duke ofruar dhe thirrje telefonike për pajtimtarët e vet. Rrjetet kabllorë kanë zgjeruar ndjeshëm zonat e ofrimit të shërbimit dhe operatori më i madh alternativ (Abcom) është operator kabllor me presence rrjeti në disa zona gjeografike (7 nga 12 qarqe);
- Shumica e operatoreve kryesore alternative dhe Albtelecom ofrojnë paketa tarifore me pagesë fikse më të mira që përfshijnë dhe thirrje telefonike në pagesën fikse. Përdorimi i paketave bundle (shporta shërbimesh) është rritur ndjeshëm. Në fundviti 2014, 41% e përdoruesve të shërbimeve telefonike të Albtelecom përdornin paketa të integruara dyfishe dhe trefishe: Telefoni, Internet dhe TV.
- Ecuria e zhvillimit të tregut të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse dhe celulare në Shqipëri tregojnë për një nivel të lartë zëvendësueshmërie të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse me ato nga rrjetet celulare;
- Diferenca midis trafikut total dales nga rrjetet celulare dhe rrjetet fikse ka vazhduar të rritet në 2012-2014, dhe në 2014 thirrjet nga rrjetet fikse përbenin vetëm 3% të thirrjeve nga rrjetet celulare dhe fikse së bashku. Trafiku nga rrjetet celulare ka vazhduar të rritet ndjeshëm ndërsa trafiku nga rrjetet fikse ka vazhduar të reduktohet ndjeshëm;
- Në rekomandimin e vitit 2014 për tregjet perkates KE ka hequr nga lista e tregjeve për nderhyrje ex-ante edhe tregun me pakice të aksesit në rrjet fikse (tregjet e tjera me pakice të telefonisë fikse janë hequr nga lista e tregjeve përkatës që në rekomandimin e vitit 2007 të KE).



## II. TREGU ME PAKICE I SHERBIMEVE TE TELEFONISE FIKSE


Sic është cituar në seksionin pararardhës të këtij dokumenti, AKEP ne analizen e tregut të vitit 2015 arriti në konkluzionin se tregjet përkatës me pakicë të telefonisë fikse të cilat ishin nën-rregullim deri në atë kohë, nuk ishin më tregje të justifikueshme për rregullim ex-ante pasi ato nuk plotësonin më testin e 3 kritereve, sipas përcaktimeve të rregullores së analizës së tregut dhe rekomandimeve të KE. Në këtë kapitull paraqiten disa zhvillime kryesore në tregun me pakice të shërbimeve të telefonisë fikse në vitet fundit, sidomos evolimi i faktoreve që çuan në dërrregullimin këtyre tregjeve me pakicë.

### III.1. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse

Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 80 sipërmarrës të autorizuar, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Një pjesë e madhe e operatoreve alternative janë të vegjel dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane. Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP dhe marrëveshjeve të interkoneksionit të lidhura me Albtelecom rezultojnë se numri i operatorëve aktivë të rrjeteve të telefonisë fikse është rreth 40.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur një rënie të vazhdueshme në 2012-2014 ndërsa në dy vitet e fundit është venë një qëndrueshmëri e këtij treguesi. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2015<sup>13</sup> ishte rreth 258 mijë, ndërsa në fund të vitit 2016 arriti në rreth 249 mijë, që përbën një rënie me 2%. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2016 arriti në 8.8%, që është shumë më e ulët se rajoni i Europës (37.7%), dhe më e ulët edhe se mesatarja botërore (13.6%).

Figura III.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonisë fikse 2000-2016



<sup>13</sup> Vlera e këtij treguesi për vitet 2014 dhe 2015 e raportuar në publikime të tjera të AKEP është rivlerësuar nga AKEP për shkak të ndryshimit të përkufizimit dhe mënyrës së raportimit të tij në këto dy periudha.



Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse të operatoreve kryesore të rrjeteve fikse për periudhën 2010-2016. Albtelcom ka pasur rënie të ndjeshme të numrit të pajtimtarëve në periudhën 2010-2013 ndërsa në tre vitet e fundit ka pasur qëndrueshmëri të tyre.

*Tabela III.1: Ecuria e numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse sipas operatoreve (2010-2016<sup>14</sup>)*

	Albtelcom	Abcom	ASC	Nisatel	OA të tjere	Total
<b>2010</b>	277,763	19,975	7,408	5,900	20,456	331,502
<b>2011</b>	258,943	27,167	10,129	4,950	37,655	338,844
<b>2012</b>	230,397	33,000	7,649	5,500	35,115	311,661
<b>2013</b>	210,382	13,680	15,047	7,166	34,925	281,200
<b>2014</b>	182,591	15,531	14,010	9,423	24,202	245,757
<b>2015</b>	180,735	12,316	30,670	4,828	24,190	252,739
<b>2016</b>	176,733	13,946	37,765	4,306	15,890	248,640
<b>Ndryshimi 2016/2015</b>	-2%	13%	23%	-11%	-34%	-2%

Numri i pajtimtareve të operatorëve alternative ka pasur luhajtje por në 4 vitet e fundit situata është më e qëndrueshme, ndonëse me trende të ndryshme midis operatorëve. Aktualisht ASC është operatori alternativ me numrin më të madhe të linjave të telefonisë fikse. Vlen të vihet në dukje se një pjesë e konsiderueshme e pajtimtarëve të shërbimeve nga rrjete fikse janë përdorues të paketave të integruara, që përfshijnë Internetin broadband fikse si shërbim kryesor, ndërsa përdorimi i telefonisë fikse është shumë i ulët.

Tabela e mëposhtme paraqet një përditesim për ecurinë e numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse për periudhën 2014-2017 T3.

*Tabela III.2: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse 2014- 2017 T3*

Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	Totali	Albtelcom	Abcom	ASC	Nisatel	OA të tjere	Pjese tregu Albtelcom
<b>2014</b>	245,757	182,591	15,531	14,010	9,423	24,202	74.3%
<b>2015</b>	252,739	180,735	12,316	30,670	4,828	24,190	71.5%
<b>2016 T3</b>	254,346	175,689	14,518	36,583	5,354	22,202	69.1%
<b>2016 T4</b>	248,640	176,733	13,946	37,765	4,306	15,890	71.1%
<b>2017 T1</b>	247,254	175,685	13,925	38,086	4,281	15,277	71.1%
<b>2017 T2</b>	245,736	175,005	14,355	39,994	3,161	13,221	71.2%
<b>2017 T3</b>	245,665	173,788	13,879	41,401	3,031	13,566	70.7%
<b>Ndryshimi tremujor</b>	-0.03%	-0.7%	-3.3%	3.5%	-4.1%	2.6%	-0.5 pp
<b>Ndryshim v-m-v</b>	-3.4%	-1.1%	-4.4%	13.2%	-43.4%	-38.9%	1.6 pp


<sup>14</sup> Në 2014 u përdor për herë të parë matja e pajtimtareve sipas pajtimtareve aktive, ndaj mund të ketë shmangje të vlerave nga raportimi i QIV 2014.

Nga të dhenat vihet re se gjate 3 tremujorëve të vitit 2017 ka vijuar trendi rënës i numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse por me ritme më të ulëta se periudhat e mëparshme. Ndërkohë pjesa e tregut e Albtelecom në numër të linjave/pajtimtarëve të telefonisë fikse ka pasur rëni me rrrth 3 pikë përqindje në vitin 2015 duke qëndruar në nivel rrrth 71% në periudhat e mëpasshme.

### Ndarja Gjeografike

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 48% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale vihet re nga grafiku i mëposhtëm, ku penetrimi mesatar për popullsi në zona urbane është 15% dhe Tirana, Gjirokastra dhe Korça kanë nivel më të lartë se kjo mesatare, ndërsa në zona rurale penetrimi mesatar është vetëm 1.4%.

**Figura III.2. Norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe zonave urbane/Rurale (2016)**



Numri i operatorëve të autorizuar të telefonisë fikse sipas qarqeve varion nga 4 në Dibër dhe Kukës në 19 në Tiranë dhe në shumë raste operatorët lokalë kanë avantazh ndaj Albtelecom për shkak të prezencës lokale më të fortë. Penetrimi në zona rurale është shumë i ulët dhe një faktor i rëndësishëm për këtë është edhe mungesa e prezencës së Albtelecom në zonat rurale.


## III.2 Trafiku telefonik i pajtimtarëve

AKEP në analizën e tregut të telefonisë në vitin 2015 krahasoi ecurinë e trafikut telefonik të origjinuar nga rrjetet fikse me ato nga rrjetet celulare për periudhën 2003-2014. Nga analiza u evidentua rënia e ndjeshme e trafikut të origjinuar nga rrjeti fiks i Albtelecom (nga rreth 570 milion minuta në 2012 në rreth 190 milion minuta në 2014) si dhe peshën shumë të ulët të thirrjeve nga rrjetet fikse në krahasim me totalin e thirrjeve të gjeneruara në rrjetet fikse: sasia totale e thirrjeve nga rrjetet fikse (Albtelecom dhe OA) në 2014 ishte rreth 220 milion minuta, dhe kjo përbente vetëm 3% të thirrjeve totale nga rrjetet fikse dhe celulare së bashku.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut telefonik të thirrjeve dalese të pajtimtarëve të telefonisë fikse të Albtelecom dhe operatorëve celulare në periudhën 2003-2015. Gjatë dy viteve të fundit 2015-2016 ka vijuar trendi rënës i thirrjeve nga rrjetet fikse, dhe në vitin 2016

pajtimtarët e Albtelecom kryen 139 milion minuta thirrje që përbën një rënie me 27% në krahasim me vitin 2014. Thirrjet nga rrjetet e operatorëve alternativë fikse kishin gjithashtu trend të ngjashëm me 32% rënie. Megjithëse në vitin 2016 u vu re një rënie me 7% e thirrjeve nga rrjetet celulare në krahasim me vitin 2014, për shkak të rënies me ritme shumë më të shpejta të thirrjeve nga rrjetet fikse, këto të fundit përbënin vetëm 2.4% të totalit të thirrjeve të origjinuara nga rrjetet fikse dhe celulare në vitin 2016.

*Figura III.3: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2010-2016*



### III.3 Tarifimi i shërbimeve me pakicë të rrjeteve fikse

AKEP në analizën 2015 si dhe në dokumenta të tjerë ka evidentuar faktin se tendencat në tarifimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri kanë ndjekur tendencat globale të përqëndrimit të paketave tarifore/ofertave të operatorëve drejt paketave me shërbime të integruara, si për përfshirje të sasive të caktuara të minuta të thirrjeve në pagesë fikse mujore dhe/ose për kombinime me të paktën dy shërbime (paketa të integruara) kundrejt pagesës fikse mujore.

Në Analizë 2015, AKEP vuri në dukje ndër të tjera se:

- Tendence e viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse ka qene promovimi i paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Operatorët më të mëdhenj alternative si Abcom dhe ASC tradicionalisht janë ofrues të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara më të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët. Gjatë vitit 2014 edhe Albtelcom filloi ofrimin e paketave trefishe, Telefoni, Internet dhe IPTV, madje edhe paketa me kater shërbime (telefoni fikse, Internet, TV dhe telefoni celulare). Deri në fund të 2014 rreth 20% e pajtimtarëve familjarë me akses broadband të Albtelcom ishin përdorues të paketave 3-fishe (telefoni, Internet dhe IPTV).
- Tarifa e pajtimit mujor standard “Familjare” e Albtelcom ne nivelin rreth 5 Euro/muaj (me TVSH) eshte me uleta ne rajon, përfshirë dhe Serbinë qe ka kaluar nga 4.5 në 5.47 euro në muaj (2014-2015). Vendet qe kane pasur Pajtim mujor te ulet si Serbia, Mali i Zi, IRJ e Maqedonisë kane levizur drejt rritjes se tarifes se pajtimit mujor dhe ndryshimet ne Shqipëri te kesaj tarife duken te ngjashme me keto vende; Sasia dhe vlera monetare e thirrjeve te perfshira ne tarifen mujore te Albtelcom jane me te lartat ne rajon (pozitive per perdoruesin). Njekoheesisht ne tarifen mujore te Albtelcom perfshihet dhe akses ne Internet 1Mbps, qe perben perfitim shtese per perdoruesit e kesaj pakete; Vlera e tarifes se pajtimit mujor te paketes standarde “Familjare” te Albtelcom eshte ne nivel te ngjashem me tarifen e pajtimit mujor te paketave me perdorim te ulet (sociale) ne Kroaci, Maqedoni, Turqi dhe Kosove dhe me perfitime ekstra (njesite te thirrjeve dhe aksesit ne Internet) me te medha se ne keto vende.
- Operoret alternative në Shqipëri kane tarifa pajtimi mujor shume te ulet, madje ASC dhe Telekom Albania ofrojne dhe paketa tarifore me parapagim (Pajtim mujor zero). Karakteristike tjeter e operoreve Alternative eshte ofrimi falas i thirrjeve brenda rrjetit (te perfshira ne pagesen mujore).
- Paketa standarde “Familjare” e Albtelcom është një ndër opsionet e paketave tarifore të Albtelcom, pasi ky operator ofron një sërë paketash tarifore dhe opsione (shporta me minuta) dhe shporta të integruara me dy, tre apo kater shërbime të komunikimeve elektronike, thirrje telefonike, akses ne Internet, IPTV dhe telefoni celulare.
- Pëqëndrimi në shërbimet e integruara dhe alternativat tarifore të Albtelcom tregojnë për rritje të fleksibilitetit dhe inovacionit të Albtelcom në ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe shërbimeve të reja në kushtet e rritjes së presionit konkurrues në treg, si nga rrjetet fikse dhe nga ato celulare;

- Reduktimi i ndjeshem i tarifave celulare ne vitet e fundit ka rritur ne mase te madhe efektin zevendesues te thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare. Kjo vihet re ne konvergjencen e nivelit te tarifave nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse (ne 2014 shpenzimi mesatar per nje minute thirrje nga rrjet celular ishte 3.12 lek/minute me TVSH). Keto vlere jane te krahasueshme me tarifat e thirrjeve nga rrjete fikse, dhe duke marre ne konsiderate lehtesine me te madhe te kryerjes se thirrjeve nga aparat celular se nga aparat fiks, presioni konkurrues eshte shume i madh. Ky efekt konvergjuet vihet re edhe ne tarifat e thirrjeve dalese nderkombetare te cilat tradicionalisht kane qene shume me te lira ne rrjetet fikse se ne rrjetet celulare.
- Shërbimet trefishe (Internet, TV dhe Telefoni fikse) tashmë janë shërbimet më atraktive në treg nga Albtelecom dhe operatorët e tjerë kryesore alternativë si Abcom, ASC dhe Abissnet.

Ecuria e tregut gjatë dy viteve 2015-2016 tregon se ato kanë vijuar trendet e tyre të mëparshem madje në përforcim sic është fokusi i operatorëve të komunikimeve elektronike në paketat e integruara. Tabelat e mëposhtëme paraqesin të dhëna për përdorimin e paketave të integruara në rrjetet fikse dhe ecurinë e ARPM në rrjetet celulare.

### **Paketat e integruara ne rrjetet fikse**

Të dhënat statistikore dhe paketat/ofertat tarifore tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezulton të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kishin akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV) në fund të vitit 2016 arriti në rreth 187 mijë, rreth 25 % më shumë se në vitin 2015. Në vitin 2016 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 70% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 35% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Këto tendenca vijuan edhe në vitin 2017 dhe në Tremujorin 3 2017 vihet re se:

- Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni/Internet/TV) në fund të 3-mujorit të dytë 2017 arriti në rreth 199 mijë, një rritje kjo 2.3% në krahasim me T2 2017 dhe rreth 12.1 % me T3 2016.
- Numri i pajtimtarëve me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV) përbën 50% të totalit të pajtimtarëve me paketa të integruara ndërsa 39% janë me paketa “Internet dhe Telefoni” dhe 11% me paketa “Internet dhe TV”.
- 69% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse në fund të T3 2017 ishin pajtimtarë me paketa të integruara (Telefoni/Internet/TV), ku 34% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

*Tabela III.3: Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara*

Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	Totali	Telefoni fikse dhe Internet	Telefoni fikse, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2014	119,230	78,419	24,330	16,481
2015	149,833	69,755	71,681	8,397
2016 T3	177,248	83,432	80,642	13,174
2016 T4	186,983	76,045	92,932	18,006
2017 T1	188,969	71,438	97,676	19,855
2017 T2	194,285	77,911	95,328	21,046
2017 T3	198,774	77,541	98,817	22,416
Ndryshimi tremujor	2.3%	-0.5%	3.7%	6.5%
Ndryshim v-m-v	12.1%	-7.1%	22.5%	70.2%

Gjatë vitit 2015, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 3 herë në krahasim me vitin 2014, ku kontributin më të madh në këtë rritje e kishte Albtelecom, që pati rritje me 3 herë të këtij treguesi në vitin 2015. Ndonëse në vitin 2016, norma e rritjes së këtyre pajtimtarëve u ngadalësua në 22% për Albtelecom (30% për të gjithë tregun), 69% e përdoruesve me akses broadband të Albtelecom ishin me paketa trefishe.

Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2016. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Albtelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2016 rreth 69% e pajtimtarëve me akses broadband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

*Tabela III.4 Numri i pajtimtarëve të Albtelecom me shërbime të integruara(2013-2016)*

	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/15
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	109,851	13%
Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	109,034	16%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	33,673	4%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	75,361	22%

### III.4. Përdorimi mesatar i thirrjeve telefonike fikse

Ndër faktorët e marrë në konsideratë për de-rregullimin e tregut me pakicë të telefonisë fikse në analizë 2015, ishte dhe efekti zëvendësues i thirrjeve nga rrjete fikse me ato nga rrjete celulare. Për këtë AKEP shqyrtoi jo vetëm ecurinë e trafikut total të origjinuar nga rrjetet fiks dhe celulare (seksionet më sipër) por edhe ecurinë e nivelit mesatar të përdorimit të thirrjeve telefonike nga rrjete fikse dhe celulare në periudhën 2010-2014. Në tabelat e mëposhtme, përveç peirudhës 2010-2014 të përdorur në Analizë 2015 janë përfshirë dhe dy vitet e fundit 2015-2016.

*Tabela III.6: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike nga rrjet fiks i Altelecom 2010-2016*

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2014
<b>Thirrje dalese</b>	151	116	106	94	81	67	65	-20%
<b>Thirrje të marra</b>	204	160	152	147	130	112	98	-25%
<b>MOU</b>	356	276	258	241	211	179	163	-23%

*Tabela III.7: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2010-2016*


	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2014
<b>Thirrje dalëse</b>	110	130	152	156	172	182	166	-3%
<b>Thirrje të marra</b>	124	147	168	167	168	171	169	1%
<b>MOU</b>	234	277	319	324	341	353	335	-2%

Te dhenat e mesiperme të konsumit të thirrjeve telefonike tregojnë se edhe në dy vitet e fundit ka vijuar trendi rënës i përdorimit të thirrjeve telefonike në rrjetin fiks të Altelecom me 20-25% rënie në vitin 2016 krahasuar me vitin 2014. Megjithatë në rrjetet celulare është vënë re gjithahstu një rënie e përdorimit të thirrjeve telefonike për përdorues në vitin 2016, normat e rënies janë shumë më të ngadalta me 2-3%.

Mesatarisht për Altelecom konsumi i thirrjeve të kryera në vitin 2016 ishte 65 minuta në muaj thirrje dalese si dhe 163 minuta në muaj thirrje të marra. Këto vlera janë 2.6 dhe 1.7 herë më të ulëta se konsumi mesatar i thirrjeve në rrjetet celulare në vitin 2015, duke cuar në rritje të hendekut të përdorimit mesatar të thirrjeve në krahasim me dy vite më parë (në vitin 2014 raporti përdorimit mesatar të thirrjeve nga rrjetet celulare me ato nga rrjeti fiks i Altelecom ishte 2.1 dhe 1.3, respektivisht për thirrje dalëse dhe thirrje të marra).

Figura e mëposhtme paraqet në mënyrë grafike ecurinë e përdorimit mesatar të thirrjeve dalëse nga rrjeti fiks i Altelecom dhe rrjetet celulare në 2010-2016, ku vihet re tendencat e kundërta midis këtyre dy treguesve: ndërsa deri në vitin 2010 thirrjet dalëse për përdorues ishin më të mëdha në rrjetin fiks se në celular, që prej vitit 2011 tendencat janë të kundërta duke vijuar në rritje të ndjeshme të hendekut të përdorimit mesatar të thirrjeve dalëse.

**Figura III. \_\_: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike fikse v celular 2010-2016**



Për sa më sipër, AKEP vlerëson se efekti zevendesues i thirrjeve telefonike fikse me thirrje telefonike celulare ka vijuar edhe në periudhën 2015-2016 dhe pritet të vijojë të jetë i qëndrueshëm edhe në vitet në vijim, ndonëse me ritme më të ulëta.

### III.5. Portabiliteti i numrit Fiks

Ky shërbim për telefoninë fikse filloi të ofrohet prej muajit Shtator 2012. Kjo lehtësi i krijon mundësinë pajtimtareve të operatoreve të telefonisë fikse që të bëjnë numrin e tyre fikse drejt operatorit që ata vlerësojnë si më atraktiv për shërbimet telefonike fikse, pa ndryshuar numrin e telefonit. Ashtu si edhe portabiliteti i numrit celular, implementimi i portabilitetit të numrit fikse ka rritur konkurrencën midis operatoreve dhe përfitimet e përdoruesve fundorë.

Në analizën 2015 AKEP evidentoj se nga të dhënat e portabilitetit të numrit fikse që prej fillimit të ofrimit të këtij shërbimi rezultonte se:

- Në total ishin portuar rreth 9500 numra telefonik fikse, që ishte rreth 4% e numrit total të pajtimtareve të telefonisë fikse;
- Albtelecom ishte operatori dhenes me i madh me rreth 7700 numra apo rreth 81% të totalit të numrave të portuar;
- Abcom ishte operatori marrës me i madh me rreth 6000 numra apo 63% të totalit të numrave të portuar;
- Numri i operatoreve që kanë shkëmbyer (marre/dhene) numra ishte 17.

Nga të dhënat për vitet 2015 e në vijim rezultojnë se numri i portimeve në rrjetet fikse ka pasur tendencë rënëse (2661 në vitin 2015, 1361 në vitin 2016 dhe vetëm 738 deri në Dhjetor të vitit 2017). Megjithatë vëhet re përsëri se:

- Albtelecom është operatori me më shumë numra të dhënë: 1050 në 2016 dhe 550 në vitin 2017 (deri në Dhjetor), apo 75-77% e gjithë numrave të portuar gjatë periudhës përkatëse;



- Abcom ishte operatori me më shumë numra të marrë: 752 në vitin 2016 dhe 410 në vitin 2017 (deri në Dhjetor), apo rreth 55% e numrave të portuar në periudhën përkatëse.

Nga analiza e ankesave të përdoruesve për portabilitetin e numrit rezulton se problemet më të mëdha të evidentuara apo ankesat përdoruesve të drejtuara në AKEP janë për poratimet e numrave celulare dhe nuk anakesa për portime të numrave fikse, çka përbën një sinjal se në tregun e telefonisë fikse nuk ka shenja të sjelljeve strategjike të operatorëve dhënës (Albtelecom si operatori më i madh dhënës).

Për sa më sipër, rezulton se sasia e numriave të portuar në rrjete fikse ka qenë në rënie, Albtelecom vijon të jetë operatori me më shumë numra të dhënë (port-out), pra dhe me me presion konkurrues të konsiderueshëm nga operatorët e tjerë të rrjeteve fikse.

### **III.6. Faktore te tjere konkurrues**

Disa nga faktoret e tjere qe AKEP morri në konsideratë në Analizë 2015 për rritjen e konkurrencës në tregun e telefonisë fikse dhe reduktimin e dominancës së Albtelecom ishin:

- Z(P)B:

Mundësia e përdoruesve të Albtelecom për përdorimin e Z(P)B për kryerjen e thirrjeve telefonike nepermjet bartesve të thirrjeve rrit përfitimet e tyre. Kjo mundësi tashmë është e disponueshme prej fundit të vitit 2011, megjithatë deri tani asnjë operator nuk ka aplikuar për Kod Bartesi dhe përdoruesit e Albtelecom ende nuk kanë filluar të nxjerrin përfitim nga ky shërbim. Një formë e ZB është kryera e thirrjeve nepermjet kartave me parapagim të OSHKP-ve, dhe ky shërbim vazhdon të përdoret nga rreth 25 mijë pajtimtare të Albtelecom (2014).

- LLU:

Mundësia e përdoruesve të Albtelecom për përdorimin e shërbimit LLU, për aksesin në Internet dhe kryerjen e thirrjeve telefonike nepermjet operatorëve të tjerë që marrin akses në rrjetin Albtelecom për LLU, rrit përfitimet e tyre. Aktualisht ky shërbim është prezent në treg prej viti 2012, dhe tarifatat për LLU janë rishikuar (reduktuar) në analizën e vitit 2014. Megjithatë ky shërbim nuk është blerë nga asnjë operator dhe se është i fokusuar në shërbim broadband, LLU e plotë krijon mundësi edhe të ofrimit të thirrjeve për pajtimtaret e Albtelecom nga ofrues të tjerë të thirrjeve telefonike. Njëkohësisht edhe LLU me akses të pjesshëm vetëm për broadband krijon mundësi e ofrimit të thirrjeve telefonike nepermjet VoB (Voice over Broadband).

- Bitstream:

Detyrimi i Albtelecom për bitstream krijon mundësi operatorëve të tjerë të ofrimit të aksesit në Internet pajtimtareve të Albtelecom duke mos pasur nevojë për investime në rrjetin backbone dhe aksesin. Ky shërbim ka filluar të përdoret nga dy operatorë dhe rezultojnë rreth 1400 linja me akses bitstream. Si edhe LLU ky shërbim megjithatë është i fokusuar për akses në Internet krijon mundësi e ofrimit të thirrjeve telefonike nepermjet VoB (Voice over Broadband) nga operatorët e tjerë duke përdorur rrjetin e Albtelecom.

Në dy vitet e fundit është venë re një rënie e ndjeshme e përdorimit të kartave me parapagim: në vitin 2015 ishin rreth 10 mijë përdorues të kartave me parapagim, ndërsa në vitin 2016 rreth 5400.

Në lidhje me LLU, megjithë masat rregulluese të AKEP si dhe reduktimet e tarifës së LLU, kjo masë nuk ka pasur efekt në treg, për shkak se shumica e operatorëve të rrjeteve fikse kanë ndërtuar dhe preferojnë të kenë rrjetin e tyre të aksesit.

Ndërkohë aksesit bitstream ka rezultuar një shërbim i kërkuar nga operatorët, duke cuar në rritje të numrit të linjave të rrjetit Albtelecom që përdoren me akses bitstream për operatorët e tjerë nga 1400 në 2014 në rreth 2400 në vitin 2016.

Gjithsesi, sic është vënë në dukje nga AKEP në analizë 2015, faktoret e mesiperm rrisin mundësitë e ofrimit të shërbimeve nga operatorë të tjerë duke përdorur rrjetin e Albtelecom pa qene nevoja për investime të mëdha në rrjetet e tyre, dhe në këtë mënyrë rrisin presionin konkurrues ndaj Albtelecom jo vetëm për shërbime broadband por edhe për telefoni (VoB) duke ndikuar në reduktimin e dominancës së Albtelecom për shërbimet telefonike me pakicë të thirrjeve telefonike. AKEP edhe në vitin 2016 ka vendosur detyrimet e mësipërme për LLU dhe akses bitstream, madje duke rezultuar edhe në reduktime të cmimit për këto shërbime dhe sidomos për aksesin në tubacione, ku ka pasur një reduktim me rreth 50% të tarifave të Albtelecom duke filluar nga Korrik 2017.

### III.7. Pjesët e Tregut dhe Tregues financiarë të Albtelecom

#### Pjesët e tregut<sup>15</sup>

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e pjesëve të tregut për numër pajtimtarësh të telefonisë fikse të Albtelecom dhe operatorëve alternativë për periudhën 2010-2017\_T3.

*Figura III.6: Pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse (2010-2017/T2)*

	Albtelecom	Abcom	ASC	OA të tjere
2010	83.8%	6.0%	2.2%	8.0%
2011	76.4%	8.0%	3.0%	12.6%
2012	73.9%	10.6%	2.5%	13.0%
2013	74.8%	4.9%	5.4%	15.0%
2014	74.3%	6.3%	5.7%	13.7%
2015	71.5%	4.9%	12.1%	11.5%
2016	71.1%	5.6%	15.2%	8.1%
2017 T1	71.1%	5.6%	15.4%	7.9%
2017 T2	71.2%	5.8%	16.3%	6.7%
2017 T3	70.7%	5.6%	16.9%	6.8%

Siç mund të vihet re pjesa e tregut për pajtimtarë të telefonisë fikse e Albtelecom ka pasur rënie deri në fund të vitit 2015, ndërsa në periudhat e mëpasshme ka qenë e qëndrueshme në nivel rreth 71%.

<sup>15</sup> Pjesët e tregut të paraqitura në këtë seksion janë për rrjetet fikse dhe **jo për tregjet që përkasin me pakicë të aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse**, pasi këto tregje përkasin sipas përkufizimit të tregut në Analizë 2015 (i pandryshuar në këtë analizë) përfshijnë edhe ofrimin e shërbimeve nga rrjetet celulare (efekti i zëvendësueshmërisë së njëanshme) dhe pjesa e tregut e Albtelecom në këtë seksion nuk interpretohet si pjesë tregu e Albtelecom në **tregun që përkasin me pakicë**, pasi sipas përkufizimit të tregjeve përkasin me pakicë ajo shumë më e vogël se vlerat në tabelat e kësaj seksioni.

Ne tabelen e mëposhtme paraqiten pjeset e tregut për pajtimtarë, thirrjet telefonike dalese dhe të ardhurat totale nga rrjeti fiks i Albtelecom për periudhën 2008-2016. Nga të dhënat mund të vihet re se megjithëse për thirrjet telefonike Albtelecom ka pjesë tregu të lartë prej 87%, pjesa e tregut në të ardhura është në nivel 60% dhe me rënie të ndjeshme me periudhat para vitit 2015.

*Tabela III.3 Ecuria e Pjesëve të tregut të Albtelecom 2008-2016*

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Pajtimtare telefoni</b>	87%	87%	84%	76%	74%	75%	74%	72%	71%
<b>Thirrje telefonike dalese</b>	93%	91%	94%	92%	89%	80%	86%	77%	87%
<b>Te Ardhura Totale nga rrjet fiks</b>	79%	78%	71%	74%	79%	72%	65%	60%	60%

### **Tregues financiarë të Albtelecom**

Tabela e mëposhtme paraqet disa tregues financiarë të Albtelecom nga shërbimet e rrjetit fiks dhe celular për vitet 2014-2016.

*Tabela III.4: Tregues financiarë të Albtelecom*

	2014	2015	2016	Ndryshimi 2016/2015
Te ardhura totale (rrjet fiks dhe celular)	10,351	9,957	9,042	-9%
Te ardhura totale nga rrjet celular	3,956	3,975	3,929	-1%
Te ardhura totale nga rrjeti fiks	6,395	5,982	5,113	-15%
Te ardhura nga shërbime me pakice (retail) në rrjet fiks	3,443	2,980	3,046	2%
Te ardhura totale nga shërbimet me shumicë të interkoneksionit rrjet fiks	2,458	2,509	1,563	-38%
Te ardhura nga shërbime të tjera me shumicë rrjet fiks	494	494	504	2%
Fitimi (humbja) neto e sipërmarresit	-2,006	-2,207	-1,245	-44%
Investime në rrjet fiks	722	456	740	62%
Investime në rrjet celular	676	1,214	344	-72%

*Shënim: Të dhënat në milion lek*

Nga të dhënat e tabelës vihet re se të ardhurat nga shërbimet e rrjetit fiks të Albtelecom kanë rënë me 15% në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë, e ndikuar kryesisht nga rënia e të ardhurave nga shërbimet me shumicë të interkoneksionit në rrjet fiks. Një impakt të konsiderueshëm në rënie e të ardhurave nga interkoneksioni vjen nga rënia e ndjeshme e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkomëbater dhe të ardhurave të Albtelecom

nga këto shërbime. Rezultati financiar i kompanisë në vitin 2016 ishte me humbje prej 1.2 miliard lek që përbën një reduktim me 44% të rezultatit negativ në vitin 2015. Megjithatë vlen të theksohet se megjithëse Albtelecom ka qenë me humbje për shumë vite (figura më poshtë), Albtelecom ka vijuar investimet të larta në rrjetin fiks dhe në atë celular.

### **III.8. Përfundim mbi ecurinë e tregut të telefonisë fikse**

Bazuar në ecurinë e faktorëve të marrë në konsideratë në tregun e telefonisë dhe rrjeteve fikse, AKEP gjykon se nuk është e nevojshme që tregjet me pakicë të telefonisë fikse të jenë objekt rregullimi ex-ante, pasi faktorët që ndikuan në nxjerrjen nga rregullimi të këtyre tregjeve në vitin 2015 vijnë të jenë prezent dhe në disa raste dhe të jenë përforcuar.

## **IV. ANALIZA E TREGJEVE PERKATËS ME SHUMICE: TERMINIMI DHE TRANZITIMI I THIRRJEVE NE RRJETET FIKSE**

### **IV.1. Perkufizimi i tregjeve te interkoneksionit**

Sherbimet ne nivelin me shumice jane sherbime te nevojshme per operatoret e rrjeteve fikse dhe celulare dhe ofruesit e sherbimeve qe te ofrojne sherbimet te telefonise perdoruesve fundore, pra ne nivelin me pakice. Ne perkufizimin e sherbimeve te telefonise fikse ne nivelin me pakice, qe behet ne kapitullin me pas, u be nje ndarje e ketyre sherbimeve ne akses dhe thirrje telefonike te disponueshme per publikun nga vendndodhje fikse. Ne nivelin me shumice sherbimet e nevojshme te operatoreve per te ofruar thirrje drejt rrjeteve te tjera jane origjinimi, terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve te cilat jane elemente te nevojshme per te ofruar thirrje telefonike pajtimtareve te rrjeteve fiks, thirrje drejt pajtimtareve te rrjeteve fiks dhe per te vijuar thirrjet drejt ketyre pajtimtareve. Njekohesisht keto sherbime sherbejne si inpute edhe per ofrimin e thirrjeve nga rrjetet celulare drejt rrjeteve fikse.

Ne analizen pararendese te vitit 2015 AKEP ka bere perkufizimin e tregjeve perkates te lidhur me tregun me pakicë të telefonisë fikse dhe të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante si me poshte.

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik alternativ fiks X<sup>16</sup>, sherbim i ofruar nga sipermarresi X sh.a;**
- **Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**


*Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofrues te sherbimit(territori i Republikes se Shqiperise per Albtelecom).*

Ne lidhje me segmentimin e tre sherbimeve terminim, origjinim dhe tranzitim AKEP ne analizat e meparshme te tregut ka dhene nje skeme ilustruese per kufijte/dallimin midis inputeve te terminimit/origjinimit dhe tranzitimit.

*Figura IV.1: Skema e elementeve (inputeve) me shumice per realizimin e thirrjeve telefonike*

---

<sup>16</sup> Cdo sipermarres qe eshte pajisur me autorizim te pergjithshem nga AKEP per ofrimin e rrjeteve publike telefonike fikse dhe eshte aktiv ne treg.



Skema e mesiperme IV.1 paraqet elementet perberes te nje thirrje telefonike brenda rrjetit fiks. Ne rastet e interkonjektivimit me nje rrjet tjetër, operatori tjetër (fiks ose celular) ka nevojë për elemente të ndryshme në varësi të pikës së interkonjektivimit dhe destinacionit (origjinim -për bartësit e thirrjeve) të thirrjeve në rrjetin fiks. Rrjetet mund të interkonektohen për të përfunduar dhe origjinuar thirrje midis njëri tjetrit ose drejt operatoreve të tjerë (tranzitim).

Skema e mesiperme i referohet me mirë rastit të një rrjeti PSTN. Me kalimin në NGN ndodhin ndryshime në hierarkinë e rrjetit dhe mënyrën e komutimit të trafikut, pasi centralet lokale dhe RSU-te që tregohen në skemë eliminohen dhe zëvendësohen nga MSAN (në rastin e FTTH apo Altelecom) dhe pika lidhje të MSAN-ve deri në centralet softsëich.

Procesi i migrimit në NGN megjithatë mund të ketë efekt në segmentet e vecanta të shërbimeve (lokal/njefish/dyfish) si dhe në mënyrën e interkonjektivimit me SS7 apo IP, ai nuk ka impakt në perkufizimin e tregjeve përkatës të terminimit/tranzitivimit/origjinimit të thirrjeve në rrjetet fikse, për sa kohë vazhdon modeli Calling Party Pays.

Gjatë kësaj periudhe nga analiza e vitit 2015 dhe viteve në vijim nuk pritet të ketë ndryshime që mund të ndikojnë në mënyrën ndarjes së shërbimeve terminimit/origjinimit dhe tranzitivimit.

Ndryshimi i perkufizimit dhe numrit të segmenteve të këtyre shërbimeve është i nevojshëm në kushtet e rrjetit të ri NGN/NGA të Altelecom, dhe AKEP ka nisur këtë proces që me analizat e mëparshme (reduktimi i segmenteve nga 3 në 2 dhe reduktimi i pikave të interkonjektivimit të Altelecom) dhe nëpërmjet Anziës së tregut në vitin 2015 vendosi për:

- Reduktimin e segmenteve të terminimit nga 2 në 1 duke filluar nga 1.01.2016
- Reduktimin e pikave të interkonjektivimit të Altelecom nga 12 në 2 duke filluar nga 1.01.2018.

Në këtë periudhë, nga analiza e vitit 2015, nuk kanë ndryshuar dhe nuk pritet të ndryshojnë një sërë faktorësh që ndikojnë në ndryshimin e konkluzioneve të mëposhtme:

- ekzistojnë tregje përkatës të vecanta për terminimin e thirrjeve në çdo rrjet fiks: pra ofrimi nga secili operator rrjeti fiks i terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet;

- tregjet e origjinimi dhe tranzitimit perfshijne ofrimin e ketyre sherbimeve nga te gjithë operatorët e rrjeteve fikse
- tregu perkates i terminimit te thirrjeve ne rrjetet fikse perfshin vetem terminimin e thirrjeve kombetare
- tregu perkates i tranzitimit te thirrjeve ne rrjetet fikse dhe terminimi ne rrjet fikse perfshin vetem tranzitimin dhe terminimin e thirrjeve kombetare
- tregu i origjinimit te thirrjeve perfshin dhe vet-ofrimin (self-supply) por nuk është me treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante.

Per nje diskutim me te detajuar per perkufizimin e tregjeve perkates te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet fikse, mund ti referoheni dokumentave te Analizave te telefonise fikse 2010 dhe 2013, qe jane te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP [akep.al](http://akep.al) ne seksionin Konsultime te Perfunduara.

Per sa me siper, AKEP gjykon qe perkufizimi i tregjeve perkates te mos kete ndryshim nga analiza e tregut e vitit 2015, d.m.th. tregjet perkates te interkoneksionit ne rrjetet fikse dhe të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante jane:

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik fikse te operatorit alternativ X, sherbim i ofruar nga sipermarresi X<sup>17</sup>;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografike te Telekom Albania (pajtimtareve Telekom Albania Fiks), sherbim i ofruar nga sipermarresi Telekom Albania sh.a.;**
- **Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**

*Dimensionimi gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofruar te sherbimit (territori i Republikës së Shqipërisë për Albtelecom dhe operatorët celulare).*

## **IV.2. Analiza per FNT e tregjeve te interkoneksionit**

### **1. Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse**

Per te analizuar ekzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33 percakton nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate. Sipas perkufizimit te tregjeve perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet fikse, çdo operator fikse eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, dhe mund te konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operatorëve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operatorëve te tjere apo konsumatoreve, eshte e rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere qe ndikojne ne kete aftesi ndikuese.

---

<sup>17</sup>Lista e operatorëve alternative eshte dhene ne Aneks 1.

Ne Analizat e viteve 2013 dhe 2015 AKEP arriti ne konkluzionin se Albtelecom dhe te gjithë operatorët alternative, perfshire Telekom Albania jane operatore me FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre:

- Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks Albtelecom;
- Sipermarresi X permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks alternativ X;
- Sipermarresi Telekom Albania sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te Telekom Albania Fiks.

AKEP si edhe ne analizat e meparshme per terminimin e thirrjeve (ne rrjete fikse dhe celulare) edhe ne kete analize ka trajtuar faktoret/kriteret e konsideruar me te rendesishem si pjeset e tregut, fuqia kundervepruese e bleresve te sherbimit dhe tarifimi i sherbimit te terminimit

### **Pjeset e Tregut**

Kontrolli 100% i rrjetit terminues nga secili ofrues i sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e tij, perben ne kete menyre edhe 100% pjese tregu, duke e identifikuar si monopolist ne ofrimin e ketij sherbimi. Ky percaktim mbi pjesen e tregut ne masen 100% nga secili operator i telefonise fikse ruan te njejten linje arsytimi te perdorur edhe ne analizat pararendese. Pjesa e tregut te terminimit te thirrjeve drejt abonenteve te rrjetit nuk varet nga madhesia e rrjetit, pasi pavaresisht madhesise apo numrit te pajtimtareve ne rrjet, secili operator eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve drejt aboneteve te vet.

Pjesa e tregut prej 100% qe secili operator ka ne terminimin e thirrjeve ne rrjetin e tij, nuk pritet te ndryshoje pasi nuk ka as alternative teknike per zevendesimin e tij:

- Teknikisht nuk ka asnje mundesi per terminimin e thirrjeve nga nje rrjet A ne nje rrjet B pa nderveprimin e operatorit qe zoteron pajtimtaret drejt te cileve eshte destinuar thirrja.
- Barrierat e natyres teknike jane te paevitueshme per te mundesuar sherbimin e terminimit te nje rrjeti tjetër ne mungese te koordinimit dhe gjetjes se nje vije sjellje te perbashket ne negociatat qe mund te zhvillohen.

Percaktimin si monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve per cdo operator te telefonise fikse e gjejme edhe nga perkufizimi i tregjeve perkates te identifikuar ne kapitullin II, sipas te cilit cdo operator fiks eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, dhe mund te konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operatoreve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operatoreve te tjere apo konsumatoreve, kjo e percakton si te rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere.

### **Fuqia Kundervepruese dhe konkurrenca e mundshme ne tregun e terminimit**

Ne Analize 2013 dhe 2015 u arrit ne konkluzionin qe edhe operatorët alternative aktive ne treg, ashtu si Albtelecom, plotesojne kriteret per FNT ne kete treg. Nepermjet rregullimit me status me FNT AKEP percaktoi tarifate e operatoreve ne treg per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre. Nga praktika shume vjecare e marredhenieve midis operatoreve per negociatat per percaktimin e tarifave te terminimit me marreveshje komerciale rezultoi ne probleme te cilat jane evidentuar ne analize 2013. Operatoret kane percaktuar tarifate gjate kesaj kohe ne



nivelet maksimale të percaktuara nga AKEP dhe nuk është vënë re që të jenë percaktuar tarifa me të uleta se nivelet maksimale për shkak të fuqisë kundërvepruese të operatoreve.

Për sa i përket konkurrencës së mundshme, për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse (dhe celulare) është arritur tashmë në konkluzionin se për shkak të karakteristikave teknike të ofrimit vetëm nga operatori i rrjetit përket të terminimit, ofrimi i këtij shërbimi nga secili operator nuk ndëshet me konkurrencë të mundshme në treg për ofrim nga operatore të tjera të ndryshme nga operatori i pajtimatrit ku perfundon thirrja telefonike.

## Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri

Në dokumentin e Analizës së tregut të telefonisë fikse, miratuar në Tetor 2015, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit dhe tranzitimit për Albtelecom dhe tarifën e terminimit për operatorët alternativë fikse, përfshirë Telekom Albania për Telekom Albania fikse, të percaktuara me FNT. Nepermjet vendimeve të vitit 2015, AKEP vendosi midis të tjerave që duke filluar nga 1.01.2016:

- Reduktimi i numrit të segmenteve të tarifimit të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse nga 2 në 1;
- Eliminimi i asimetrisë së tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të operatoreve alternativë me tarifën e terminimit në rrjetin Albtelecom,
- Heqjen e tarifës fikse për thirrje (0.38 lek/thirrje).
- Reduktimi i tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse sipas një reduktimi të përshkallëzuar në 3 periudha (periudha e tretë nga 1.01.2018 objekt rishikimi sipas analizës së rradhës së tregut fikse).

Tabelat e mëposhtëme paraqesin ecurinë e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse në Shqipëri nga viti 2010 e në vijim si dhe përfshijnë dhe tarifën e percaktuara në vendimet e mëparshme të AKEP dhe afatet kohore të aplikimit të tarifave sipas Analizës së tregut 2015.

*Tabela IV.1: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fikse Albtelecom (2010-2018)*

	1.09.2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018
<b>Terminim – (lek/minute)</b>						
<b>Lokal</b>	1.5	1.34	1.19	1.48	1.29	0.70
<b>Njefish</b>	2.5					
<b>Dyfish</b>	3.5	2.68	1.85			
<b>Tranzitim (lek/minute)</b>						
<b>Njefish</b>	1.5	1.71	1.32	0.93	0.81	0.44
<b>Dyfish</b>	2.5					
<b>Tarife per thirrje (lek/thirrje)</b>	0.83	0.53	0.38	0.00	0.00	0.00
<b>POI</b>	84	12	12	12	12	2

*Tarifat pa TVSH*

*Tabela IV.2: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe Telekom Albania për Telekom Albania fikse (2010-2018)*

	2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018
--	------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

OA							
	<b>Lokal</b>	1.5-1.95	1.5	1.34	1.48	1.29	0.7
	<b>Mesatare-Njefish/dyfish</b>	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77			
	<b>Tarife fikse per thirrje</b>	0.83	0.53	0.38	0	0	0
Telekom Albania							
	<b>Terminimi lek/minute</b>	1.50 ose 2.5	1.34	1.19	1.48	1.29	0.7
	<b>Tarife fikse per thirrje</b>		0.53	0.38	0	0	0

Tarifat pa TVSH

Tarifat e terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri janë reduktuar në baze të vendimeve të AKEP dhe jo për shkak të presionit konkurrues me të cilin ndeshen operatorët apo faktorë të tjerë si fuqia kundërvepruese. Tarifat e terminimit janë përcaktuar në nivelet maksimale të lejuara nga AKEP dhe nuk ka pasur tendencë për përcaktim të tarifave poshtë këtyre niveleve. Tarifat aktuale të terminimit në rrjetet fikse janë reduktuar ndjeshëm në dy vitet e fundit, por ende janë më të larta se tarifat mesatare në vendet e BE. Në mungesë të rregullimit ex-ante me statusin me FNT operatorët do të mund të tarifonin tarifa mbi nivelet e rregulluara dhe vlera të ndryshme për operatorë të ndryshëm (diskriminim).

### **Perfundime mbi FNT në tregjet e terminimit:**

Bazuar në përfundimet e këtij seksioni, AKEP vlerëson se Albtelecom dhe të gjithë operatorët alternativë, përfshirë Telekom Albania janë operatorë me FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre:

- *Albtelecom sh.a. përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarres me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtareve të rrjetit fikse Albtelecom;*
- *Sipërmarresi X përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarres me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtareve të rrjetit fikse alternativ X;*
- *Sipërmarresi Telekom Albania sh.a. përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarres me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtareve të Telekom Albania Fiks;*

Lista me operatorët alternativë (të referuar me sipër si Sipërmarresi X) të propozuar për status me FNT për terminimin në rrjetet e tyre është dhënë në Aneks 1 të këtij dokumenti të analizës. Lista është hartuar duke u bazuar në të dhënat e Rregjistrimit të Autorizimit të përgjithshëm si dhe të dhënat e rregjistrimit të Autorizimit Individual për sipërmarresit e pajisur me numeracion gjeografik Fiks deri më 30.12.2017. Për sipërmarresit që përcaktohen me FNT janë sipërmarresit që kanë njoftuar për ofrim rrjeti publik telefonik fikse (rrjet publik fikse dhe telefoni fikse) sipas të dhënave të Rregjistrimit të AP dhe që njekohesisht janë pajisur me numeracion gjeografik fikse deri më 30.12.2017.

## **2. Tranzitimi i thirrjeve në rrjetet fikse**

Tranzitimi i thirrjeve shërben për të lidhur dy rrjete që nuk kanë lidhje direkte me njëri-tjetrin apo kur kjo lidhje direkte nuk konsiderohet ekonomike nga palet. Për tranzitimin e thirrjeve kombëtare Albtelecom aktualisht është operator me FNT dhe tarifat e tranzitimit kontrollohen dhe rregullohen nga AKEP. Sherbimi i tranzitimit kërkohej nga operatorët e rrjeteve fikse për të kompletuar thirrjet telefonike të përdoruesve të tyre drejt rrjeteve të tjera (jo të interkonektuar direkt). Në analizat pararendëse AKEP ka dhënë perkufizimin e këtij sherbimi bazuar në RIO-n e publikuar nga Albtelecom dhe gjithashtu ka përcaktuar edhe tarifen

maksimale per tranzitim te Albtelecom, e cila aktualisht është 0.81 lek/minutë krahasuar me 1.32 leke/minute në vitin 2014.

## Pjeset e tregut

Per te vleresuar fuqine e ndjeshme ne kete treg si edhe ne tregjet e tjere faktor i rendesishem eshte pjesa e tregut. Edhe ne analizat pararendese ky treg ne kushte e Shqiperise ka rezultuar te dominohet nga Albtelecom. Sipas të dhënave të depozituara nga operatorët pjesët e tregut të Albtelecom për shërbimin e tranzitimit të thirrjeve kombëtare janë dhënë në tabelën e mëposhtëme për 2014-2016.

*Tabela IV.1 Pjeset e tregut te Albtelecom Tranzitim thirrjesh kombetare (2014-2016)*

<b>Market Shares Tranzitimi Kombetar</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>Volum Thirrjesh (minuta)</b>	70%	97%	99%
<b>Te ardhura</b>	75%	77%	90%

Megjithëse në analizën e vitit 2015 AKEP evidentoi një rënie të pjesës së tregut për tranzitimin e thirrjeve kombëtare deri në nivele 60-70% krahasuar me nivele mbi 90% në periudhat e mëparshme, në dy vitet e fundit vihet re një rritje përsëri e pjesës së tregut të Albtelecom, duke arritur në 99% për volum të thirrjeve dhe 90% për të ardhura nga tranzitimi i këtyre thirrjeve.

Ndryshimet e mëdha ne pjeset e tregut per tranzitimin e thirrjeve kombetare tregojne se operoret alternative nuk kane krijuar ende sherbim te qendrueshem tranziti kombetar, por dhe se të dhënat e raportuara kanë problem me saktësisinë e tyre. Megjithëse kjo çështje do jetë object I saktësimi nga AKEP në muajt në vijim, AKEP vlerëson se Albtelecom zotëron pjesë të konsiderueshem tregu që janë shenja të dominancës së tij në këtë treg.

## Barriera per hyrjen ne tregun e tranzitit kombetar

Megjithë heqjen e barrierave ligjore per hyrjen ne tregun e tranzitimit te thirrjeve, gje e cila reflektohet edhe nga rritja e numrit te ofruesve te ketij sherbimi dhe rritja e pjeses se tregut te tyre, perseri ky treg ndodhet nen efektin e barrierave te rendesishme me natyre ekonomike, pasi mbulimi me infrastrukturen e nevojshme te territorit kombetar apo edhe zona te konsiderueshme per ofrimin e ketij sherbimi, kerkon investime te medha. Vazhdon te jete prezente ekzistenca e operatoreve alternative me mbulim te kufizuar gjeografik qe e kane te nevojshme sherbimin e tranzitimit nga Albtelecom per t'iu ofruar pajtimtareve te tyre nje sherbim telefonik ne pakice me mbulim jashte mundesive qe iu ofron rrjeti i tyre. Duke marre parasysh sasine qe duhet investuar dhe faktoret vendas qe ndikojne ne normen e kerkuar te kthimit ndaj ketij investimi mund te mendojme se eshte e veshtire per kapacitet qe kane shumica e operoret alternative te zgjerojne mbulimin gjeografik ne gjithe Republiken e Shqiperise. Megjithese disa nga keta operoret kane pasur tendenca positive ne kete drejtim sic edhe eshte evidentuar ne analizen pararendese, perseri mbulimi i tyre vazhdon te jete me i vogel se ai i Albtelecom. Nje faktor i tille, vazhdon ti krijoje avantazh konkurrues Albtelecomit si operatori kryesor dhe vazhdon te mbaje poziten dominuese te tij ne kete treg.

## Fuqia Kundervepruese

Ne mungese te nderhyrjes rregullatore per te rregulluar sherbimin e tranzitit kombetar, aftesia qe operatori Albtelecom te demonstroje dominancen e tij do te ishte e padiskutueshme, kjo pasi mundesia qe zbehja e dominances se Albtelecom ne kete treg te vinte si rezultat i fuqise kundervepruese nga palet blerese te ketij sherbimi do te ishte relativisht e vogel. Per rrjedhoje ky faktor do te ishte ne disavantazh te konkurrences efektive ne kete treg

### **Konkluzioni per tregun e tranzitit kombetar**

Niveli i pjeses se tregut te Albtelecom për tranzitimin e thirrjeve kombëtare eshte shumë i madh dhe avantazhet e Albtelcom ne madhesine e rrjetit (mbulim dhe prezence gjeografike) ne raport me operatoret e tjera fiks, numri i larte i operatoreve alternative me prezence te kufizuar gjeografike, rrisin aftesine dominuese te Albtelecom ne kete treg.

Nga vleresimi i faktoreve te fuqise kundervepruese te bleresve te ketij sherbimi, si dhe vleresimeve mbi mundesite e zhvillimit te konkurrences ne kete treg, prezences se barrierave te hyrjes ne kete treg etj, AKEP gjykon se :

*Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun perkates te tranzitimit te thirrjeve kombetare.*

## V. MASAT RREGULLUESE PER OPERATORET ME FNT

Ne baze te analizes se kryer per tregjet e telefonise fikse, rezulton se:

**Sipermarresi Albtelecom sh.a** vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregjet perkates te meposhtem:

- *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publik telefonik Albtelecom te ofruar nga vendndodhje fikse.*
- *Tregu me shumice i sherbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombetare ne rrjetet telefonike publike te ofruara nga vendndodhje fikse.*

**Sipermarresi X** i rrjetit alternativ X vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregun e shumices te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, konkretisht ne tregun:

- *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publik telefonik te operatorit X te ofruar nga vendndodhje fikse.*

**Sipermarresi Telekom Albania** vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregun e shumices te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, konkretisht ne tregun:

- *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjet publik telefonike Telekom Albania drejt numrave gjeografike te ofruara nga vendndodhje fikse (per pajtimtaret e Telekom Albania Fiks).*

Pika 2 e Nenit 34 te ligjit 9918, percakton midis te tjerave se *nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuara në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Pika 3, Neni 34 i Ligjit 9918 dhe pika 5 e nenit 3 te Rregullores se Analizes se Tregut, percaktojne midis te tjerave se: *Në qoftë se AKEP gjatë analizimit dhe përcaktimit të një tregu arrin në përfudimin se, ky treg nuk plotëson një nga kriteret e referuara në piken 4 të këtij neni, AKEP nuk vendos detyrime rregullatore në këtë treg ose anulon detyrimet rregullatore ekzistuese, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918.*

Per sa me siper rezulton se tregjet perkates ne te cilat ka operatore me FNT jane tregjet e terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te telefonise fikse si dhe tregu i tranzitimit te thirrjeve kombetare ne rrjetet fikse. AKEP ne analizat e meparshme ka evidentuar problematiken e FNT ne keto tregje dhe problematika e tregut te terminimit ne rrjetet fikse eshte tashme e miretrajtuar pasi ato jane probleme standarde qe do te ekzistionin ne kushte e mos-rregullimit ex-ante:

- refuzimi per te dhene akses ne rrjet per sherbimet e interkoneksionit;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- aplikimi i kushteve te padrejta ne marreveshje interkoneksioni.

Seksionet e meposhteme permbajne propozimet e AKEP per detyrimet e operatoreve me FNT.

## **V.1. Masat rregullatore per tregjet me shumice te interkoneksionit**

### **1. Masat rregullatore per Albtelecom**

AKEP gjykon se problemet e tregjeve me shumice nga FNT e Albtelecom per terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombetare ruajne te njejten natyre me problemet e identifikuar nga analizën e meparshme 2015, keshtu qe ndaj operatorit me FNT Albtelecom propozohet qe detyrimet aktuale te qendrojne dhe te vazhdoje implementimi i tyre dhe konkretisht:

- **Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**
- **Detyrimi i transparencës (Neni 40)**
- **Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**
- **Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45)**

AKEP, gjykon se per te realizuar objektivat rregullatore te AKEP, te listuara ne piken 3 te nenit 7 te Ligjit 9918, per FNT per terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve ne rrjetin Albtelecom, te gjitha masat e cituara jane te nevojshme per Albtelecom.

Pervec detyrimeve te citura me siper, Albtelecom duhet te zbatojne dhe detyrimet e Ligjit 9918 per akses dhe interkoneksionin, perfshire afatet kohore te dhenies se ofertes se aksesit kerkuesve dhe dorezimin ne afat te MI-ve dhe publikimin/përdirtësimin e RIO. Detajime te detyrimeve te operatoreve me FNT ne lidhje me interkoneksionin si dhe RIO jane pjese e rregullores te Akses dhe Interkoneksionit.

Albtelecom duhet te publikoje gjithashtu marreveshje te Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore te Performances (Key Performance Indicators - KPI) per interkoneksionin sipas percaktimeve te Rregullores se Akses dhe Interkoneksionit.

### **2. Masat rregullatore per terminimin ne rrjetet e OA dhe Telekom Albania**

AKEP ka vleresuar nepermjet analizes, qe operatoret alternative te rrjeteve te telefonise fikse plotesojne kushtet per FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre individuale. Ne lidhje me masat rregullatore/detyrimet per FNT te ketyre operatoreve AKEP gjykon qe te kene te njejat detyrime te vendosura edhe ne analizen e tregut te kryer ne vitin 2013:

- **Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39)**
- **Detyrimi i transparencës (Neni 40)**
- **Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**
- **Detyrimi per kontroll tarife**

**Detyrimi i mosdiskriminimit** perfshin ndalimin e aplikimit te tarifave te ndryshme te terminimit te thirrjeve hyrese kombetare per operatore te ndryshem kombetar origjinues te thirrjeve te terminuara ne rrjetin e operatorit alternativ. Pra nepermjet ketij detyrimi nje operator alternativ nuk mund te aplikojte tarifa te ndryshme terminimi per operatore te ndryshem si celulare ashtu edhe fiks.

AKEP si edhe ne analizat e meparshme 2013 dhe 2015 gjykon qe operatoret alternative te mos kene detyrim per publikim oferte reference interkonesioni, pasi kjo mase nuk eshte e nevojshme dhe do te ishte jo-proporcianale.

**Detyrimi i transparences** perfshin publikimin nga operatori alternative te tarifes/tarifave te terminimit ne rrjetin e tij si dhe te adreses se pikes se interkoneksionit me kete rrjet. Ne kushtet e mos-vendosjes se detyrimit per publikim RIO ky detyrim gjykohet i nevojshme per zbatimin e mos-diskriminimit ne tarifa.

**Detyrimi i dhenies akses** per interkoneksion eshte detyrim qe operatoret rrjeteve publike telefonike te japin akses per terminim ne rrjetet e tyre me qellim realizimin e interkoneksionit te rrjeteve publike telefonike.

**ANEKS 1. LISTA E SIPERMARRSVE TE RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TE PERCAKTUAR PER STATUS ME FNT NE TERMINIMIN E THIRRJEVE<sup>18</sup>**

Tabela e mëposhteme paraqet listen e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete publike fikse dhe të pajisur me numeracion gjeografik fikse për pajtimtare, të cilët do të përcaktohen me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse.

<b>Nr</b>	<b>Sipërmarrës</b>
1.	4 ALB sh.p.k
2.	ABCOM sh.p.k
3.	Abissnet sh.a
4.	Administration, Management, Bussines, Etc sh.p.k
5.	Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k
6.	Albanian Carrier Telecommunication sh.p.k.
7.	Albanian Satellite Communications sh.p.k
8.	Tirana Tel sh.p.k (Ish ATP)
9.	ALBON sh.p.k
10.	Alma 2001 sh.p.k
11.	Arsen Shahaj (Person Fizik)
12.	ALSER COMPANY ALBANIA sh.p.k
13.	BITRI sh.p.k
14.	Bleta sh.p.k.
15.	DIGICOM sh.p.k.
16.	DOVA sh.p.k
17.	EDEN sh.p.k
18.	EDI – 2004 sh.a
19.	EGIS – TEL 2004 sh.p.k
20.	EJ & BI sh.p.k
21.	ELCOM sh.p.k
22.	ELITE Telecommunication sh.p.k.
23.	Enada – Online sh.p.k
24.	ESDE Consulting sh.p.k.
25.	TELEKOM -KO sh.p.k (Ish ESPACE sh.p.k)
26.	FABBTEL sh.p.k
27.	FOXCOM sh.p.k.
28.	FBD sh.p.k
29.	FJOERS ONLINE sh.p.k
30.	Greta Gjini (Person Fizik)

<sup>18</sup> Kjo listë nuk përfshin Albtelecom dhe Telekom Albania, të cilët janë shpallur me FNT me vendime të veçanta.



31.	GRUPKOM sh.p.k.
32.	IDISTRIBUTION sh.p.k
33.	INFO – Telecom sh.p.k
34.	IVA Elektronik sh.p.k
35.	Lorenc Bushi (Person Fizik)
36.	MC Netëorking SH.P.K
37.	Metis Communications sh.p.k
38.	Merita Xhika (Person Fizik)
39.	Mobitel Communication sh.p.k
40.	Neofone sh.p.k
41.	NISATEL sh.p.k
42.	Orikum Telecommunication sh.p.k
43.	PEGASUS COMMUNICATIONS sh.p.k
44.	Professional Technologies sh.p.k.
45.	PROTON COMMUNICATION sh.p.k.
46.	RAYSTORM sh.p.k
47.	RU – TEL sh.p.k
48.	SABATEL sh.p.k
49.	Sajet sh.p.k
50.	Selcom sh.p.k
51.	SHKODRA INTEL.TV sh.p.k
52.	SIN-TEL sh.p.k
53.	TEEB-CENTER sh.p.k
54.	Tele.Co Albania sh.p.k.
55.	Telekom Postriba sh.p.k
56.	Telekomunikacion Group sh.p.k.
57.	TEL-KOM sh.p.k
58.	Treg Tur Korça sh.p.k.
59.	UltraNet (Ish Albanian Telecommunication Netëork)
60.	UNIFI HOLDINGS INC sh.p.k.
61.	VIVO Communications sh.p.k
62.	Vasfi Balla
63.	VOSKOPI sh.p.k
64.	Vraninger Communications sh.p.k
65.	Ëings.Co Degë e Huaj në Shqipëri
66.	XHENI A.D. sh.p.k

## **ANEKS 2. LISTA E PYETJEVE PËR KËSHILLIM PUBLIK DHE KOMENTET E PALËVE TË INTERESUARA<sup>19</sup>**

Me vendimin nr. 28 të datës 27.12.2017 Këshilli Drejtues i Akep vendosi të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse.

Procedura e këshillimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe masave rregulluese të propozuara për FNT, përfshirë rregullimin e tarifave me shumicë për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, është kryer për një periudhë 2 (dy mujore) dhe përfundoi me datë 28.02.2018.

Në përfundim të këshillimit publik palët e interesuara u shprehën lidhur me dokumentin. AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrsit në këtë proces këshillimi për komentet dhe sugjerimet e dhëna në komunikime të cituara më sipër. Në dokumentin e nxjerre në këshillim publik, AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrë opinionin e palëve të interesuara.

Ky Aneks më poshtë përmban komentet e dërguara nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet:

- Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën nr. 11/1 prot., datë 21.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/4 prot., datë 26.02.2018);
- Altelecom sh.a me shkresën Nr. 1813 Prot., datë 28.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/5 prot., datë 28.02.2018);
- Vodafone Albania sh.a me shkresën ref. LEA/020/IL., datë 28.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/6 prot., datë 01.03.2018);
- Telekom Albania sh.a me shkresën Nr. 1215, datë 15.02.2018 (referenca e AKEP: nr. 2345/3 prot., datë 21.02.2018).

Për orientim dokumenti më poshtë është stukturuar në këtë mënyrë:

### **I. Komete të përgjithshme**

Kjo pjesë përmban komentet e dhëna nga palët e interesuara në përgjithësi për dokumentin, dhe jo në mënyrë specifike për pyetjet e këshillimit publik, si dhe qëndrimi i AKEP për këto komente të përgjithshme.

### **II. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik**

Kjo pjesë përmban komente e palëve të interesuara të grupuara sipas pyetjeve të këshillimit public dhe qëndrimi i AKEP për komentet për çdo pyetje.

#### **I. Komete të përgjithshme**

#### **Komentet e Autoritetit të Konkurrencës**

---

<sup>19</sup> Pyetja nr.7 lidhur me tarifën FTR të publikuara për konsultim publik dhe opinionet e palëve lidhur me çështjet e tarifave të terminimit në rrjetet fikse do të përfshihen në një dokument të veçantë të këshillimit public(nr 2) vetëm për tarifën.

1. Tregjet me shumicë të telefonisë fikse të përcaktuara nga AKEP, diktojnë rregullimin ex-ante dhe vendosjen e detyrimeve nga AKEP mbi operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (FNT);
2. Në analizën e radhës, rregullimi i tarifave të shumicës nga AKEP të kryhet duke i orientuar ato drejt kostos reale të tyre;
3. Mbi shtyrjen e aplikimit të reduktimit të tarifave të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fiks, vlerësojmë që AKEP të marrë në konsideratë dhe të analizojë të gjitha pretendimet dhe argumentet që mund të paraqesin palët e interesuara gjatë kësaj procedure këshillimi;
4. Lidhur me tregun me pakicë të shërbimeve të telefonisë fikse, duke parë dinamikën e ulët të tregut, barrierat e larta të hyrjes, penetrimin e ulët të tregut, pjesët e larta dhe të qëndrueshme në të gjithë treguesit të ndërmarrjes Albtelecom, përqendrimin e lartë të tregut (HHI), transmetimin e fuqisë së tregut me shumicë në tregun me pakicë (integrim i fuqishëm vertikal) për periudhën pas analizës së vitit 2015, vlerësojmë se AKEP duhet të marrë masa për rregullimin ex-ante të këtij tregu, duke shpallur FNT operatorin “Albtelecom” SHA dhe marrjen e masave përkatëse rregullatore, siç janë detyrimi për transparencë, mos-diskriminim, rregullim tarifash, etj., ndaj kësaj ndërmarrjeje;
5. AKEP në tregun me pakicë të shërbimeve të telefonisë fikse duhet të kryejë një analizë krahasimore të tarifave me pakicë që aplikojnë ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në këtë treg, për ta krahasuar nëse është reflektuar reduktimi i tarifës me shumicë, për të parë kushtet e këtij tregu dhe sjelljen e operatorit me pozitë dominuese krahasuar me operatorët e tjerë alternativë.

#### Qëndrimi i AKEP

AKEP vlerëson Autoritetin e Konkurrencës për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe komentet në lidhje me analizën e telefonisë fikse.

Lidhur me komentin 1 AKEP sqaron se pas procesit të analizës së tregut të vitit 2015 Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur de-rregullimin e tregjeve me pakicë të telefonisë fikse si tregje që nuk ishin më të justifikueshem për ndërhyrje ex-ante.

Faktet që tregu i telefonisë fikse nuk ka zhvillimin dhe penetrimin e tregut mobile, zëvendësueshmëria e njëanshme e tregut të shërbimeve të fiksit nga ana e shërbimeve mobile (e anasjellta sështë zëvendësim i plotë), numri relativisht i konsiderueshëm i hyrjeve në treg (mbi 80 operatorë) dhe rritja e konkurrencës ndaj operatorit incumbent Albtelecom (i cili nuk është as konkurrenti kryesor në disa rajone) nuk justifikojnë rregullimin ex-ante të tregut të telefonisë fikse.

Pjeset e tregut të paraqitura në Kapitullin III të dokumentit të analizës së tregut për rrjetet fikse dhe jo për tregjet përkatës me pakicë të aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse, pasi këto tregje përkatës sipas përkufizimit të tregut në Analizë 2015 (i pandryshuar në këtë analizë) përfshijnë edhe ofrimin e shërbimeve nga rrjetet celulare (efekti i zëvendësueshmërisë së njëanshme) dhe pjesa e tregut e Albtelecom në këtë seksion nuk interpretohet si pjesë tregu e Albtelecom në tregun përkatës me pakicë, pasi sipas përkufizimit të tregjeve përkatës me pakicë ajo shumë më e vogël se vlerat në tabelat e këtij seksioni. Një analizë më e detajuar për përkufizimin e tregjeve përkatës me pakicë të

telefonisë fikse është dhënë në Analizën e tregut 2015. Bazuar në vlerësimin e ndryshimeve në treg pas analizë 2015 dhe pritshmëritë për zhvillimet në 2-3 vitet e ardhme, AKEP nuk ka ndryshuar përkufizimin e tregjeve përkatës me pakicë të telefonisë fikse, pra ai përfshin dhe shërbimet e telefonisë celulare (zëvendësim i njëanshëm) si dhe konkluzionin që nuk përbën treg të justifikuar për ndërhyrje ex-ante.

Lidhur me komentin 2 të AK AKEP sqaron se rregullimi i tarifave të terminimit sipas parashikimeve të nenit 57 pika 2 të ligjit “Për komunikimet elektronike” kryhet duke marrë parasysh (një ose disa nga metodat):

- Praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
- Tarifat mesatare të vendeve të BE
- Tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me RSH
- Raportet mes tarifave të shumicës dhe pakicës
- Normën e fitimit të arsyeshëm

Lidhur me pikën 3 AKEP do të marrë parasysh pretendimet e palëve dhe do të rizhillojë një këshill publik të posaçëm për çështjen e vendosjes së tarifave.

Lidhur me pikën 4 dhe 5 janë të njëjtat shpjegime të dhëna në pikën 1.

#### Komente të përgjithshme Albtelecom

Albtelecom sh.a. në përgjigje të dokumentit për konsultim publik “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike”, pasi u njoh edhe me masat rregulluese të propozuara në tregjet me shumicë dhe me propozimin për reduktimin e metejshëm të tarifave të terminimit të operatorëve fiks dhe Albtelecom, parashtron komentet dhe qëndrimin e tij më poshte dhe në vijim jep përgjigje mbi pyetjet në dokumentin e analizës:

**Lidhur me skemën e propozuar nga AKEP për reduktimin e tarifave të terminimit (FTR-se) në rrjetet fikse dhe tarifës së tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom, gjykojmë se nuk është e justifikuar dhe nuk mbështetet për arsye thelbësore të kushteve dhe rrethanave të telefonisë fikse në Shqipëri, pjesë të konsiderueshme të cilave janë të evidentuara lehtësisht edhe përgjatë dokumentit të Analizës së AKEP, si me poshtë:**

Efekti zëvendësues në rritje i shërbimeve të telefonisë fikse me shërbime nga rrjetet celulare që ka cuar në tkurrjen e sektorit të telefonisë fikse dhe treguesve kryesore të tij përsa i takon numrit të abonenteve, trafikut të interkoneksionit, të ardhurave, normës së penetrimit, etj.

Ulja e konsiderueshme e trafikut të terminuar në rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse, si rrjedhojë edhe e përdorimit në masë të aplikacioneve të tillë si ehat's up, viber, dhe messenger, etj, c'ka impakton direkt të ardhurat e operatorëve nga trafiku telefonik.

Trendi gjithnjë zbritës i të ardhurave të operatorëve të telefonisë fikse, të cilat për Albtelecom në vecanti janë reduktuar me rreth 15% për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, ndërkohë që investimet tona në rrjetin dhe infrastrukturën e telefonisë fikse kanë vijuar në rritje si një domosdoshmëri për t'i siguruar dhe sjellë abonentit shërbim me të mirë (rritja e investimeve për vitin 2016 rreth 62% krahasuar me vitin 2015).

Vështirësia dhe pamundësia për përfitimin nga ekonomite e shkallës si për operatorët alternativë, ashtu dhe për vetë Albtelecom për shkak të ekzistencës së një numri të madh operatorësh, që shërbejnë edhe lokalisht dhe me madhësi të kufizuar të rrjetit, të numrit të vogël të popullsisë së shërbyer, efektit zëvendësues të telefonisë celulare, etj.

Normë penetrimi shumë të ulët dhe në rënie vit pas viti krahasuar me cdo vend tjetër të EU-së apo Rajonit, si dhe trend zbritës në numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse prej vitit 2015 e në vazhdim.

Informaliteti i mundshëm në tregun e komunikimeve elektronike e adresuar nga Albtelecom edhe me shkresë zyrtare pranë AKEP mbi operimin e mundshëm në rrugë informale të operatorëve, cka shkakton konkurrencë të pandershme duke i dhënë mundësinë operatorëve informale për gjenerimin e të ardhurave në menyrë të padrejtë dhe uljen e të ardhurave për Albtelecom, i cili nga ana e tij përmbush me korrektësi detyrimet ligjore dhe rregullatore.

Ngarkesat e vazhdueshme dhe të padrejta ndaj Albtelecom nga thellimi i aplikimit të taksave në menyre jo proporcionale nga njësitë e ndryshme vendore të paktën që prej vitit 2011 mbi infrastrukturën e telefonisë fikse e cila rrit kostot dhe shpenzimet dhe përkeqëson gjendjen financiare të Albtelecom.

Dëmtimet e vazhdueshme nga të tretët në infrastrukturën e rrjetit, të cilat Albtelecom detyrohet në shumicën e rasteve t'i rikuperojë me kostot e veta. Edhe ky faktor ndikon ndjeshëm në kostot dhe shpenzimet e Albtelecom dhe përkeqëson gjendjen financiare të tij.

Pikërisht, duke konsideruar si shumë të rëndësishme kushtet dhe rrethanat e mësipërme aspak të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së apo rajonit, karakteristikat e këtij tregu në Shqipëri, është më se e qartë dhe e arsyeshme **që tarifat e terminimit dhe të tranzitimit jo vetëm të mos reduktohen, por përkundrazi të rriten arsyeshmërisht për të shërbyer edhe për një nga qellimet e rregullimit të kësaj tarife që është nxitja për investime në rrjetin fiks, pjesë e të cilit është dhe broadband.**

Per më tepër, që tarifat e terminimit të operatorëve të këtij tregu dhe tarifa e tranzitimit të Albtelecom nuk kanë patur prej kohësh dhe nuk kanë aspak ndikim në tarifimin e thirrjeve me pakicë dhe më tej akoma në vendimin final të abonentit për të kryer thirrje nga rrjeti fiks, sa kohë që edhe thirrjet e ofruara falas (brenda pagesës mujore) nga operatorët alternativë dhe Albtelecom kanë përdorim shumë të vogël, dhe vijueshmërisht në ulje prej vetë abonentëve.

Nga referimi në vendet e BE-së, është i evidentueshëm lehtësisht rasti i vecantë i Polonisë, ku ne dallim nga gjithë vendet e tjera të këtij grupi mban tarifën e terminimit prej rreth 1.51 lekë/min. Ne besojmë që janë pikërisht specifikat dhe rrethanat e vecanta në Poloni për të cilat Autoriteti Rregullator i Polonisë i ka konsideruar dhe ka përcaktuar mbajtjen e kësaj tarife terminimi, që është krejtësisht e ndryshme nga tarifa e terminimit benchmark e vendeve të tjera.

Prandaj, *Albtelecom gjykon se reduktimi i propozuar i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse si dhe i tarifës së tranzitimit nga 01.09.2018 në 1 lek/min dhe 0.63 lek/min respektivisht, dhe reduktimi i metejshëm i propozuar nga 01.01.2019, jo vetëm që është i pajustificuar, por vetëm sa çon në mënyrë të pashmangshme në uljen e metejshme të të ardhurave të operatorëve në telefoninë fikse dhe rrjedhimisht edhe në ulje të stimulit për*

*rritje të investimeve të tyre në rrjetet fikse, dhe duke patur asnjë përfitim për përdoruesin fundor/abonentin.*

Kështu, megjithë përpjekjen për të mirëkuptuar qasjen e AKEP për reduktimin e kostos së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, por nga ana tjetër:

- në kushtet dhe rrethanat renditur më lart, që kanë çuar vetëm rënien e vazhdueshme të të ardhurave të operatorëve të telefonisë fikse, si dhe;
- bazuar në mos ndikueshmërinë prej kohësh tashmë të nivelit të tarifës së terminimit apo tranzitimit në perfitimet e mëtejshme të përdoruesit fundor/abonentit;
- ekzistencën e të paktën një praktike në EU të tarifës së terminimit të dalluar nga vendet e tjera të grupit të EU-së.

*Albtelecom gjykon si të domosdoshme dhe kërkon nga AKEP vendosjen e tarifës së terminimit prej 1.51 Leke/min dhe 1 lekë/min të tranzitimit të paktën deri në analizën tjetër të radhës të tregut të telefonisë fikse.*

Në çdo rast që AKEP mund të gjykojë ndryshe, atëherë cdo lloj përcaktimi i këtyre tarifave duhet të jetë racional dhe i justifikuar me qëllim që të shërbejë konkretisht për përfitueshmërinë e përdoruesit fundor dhe të nxitjes së investimeve në rrjetet fikse dhe jo të rezultojë thjesht në tkurrje të vazhdueshme të të ardhurave të Albtelecom apo dhe të gjithë operatoreve të telefonisë fikse. Në këtë kontekst, ritheksojmë edhe njëherë se çdo lloj reduktimi i FTR-së para vitit 2019 dhe përshkallëzimi i metejshëm gjatë vitit 2019, për më tepër në masat respektive 23% dhe 30% të propozuar nga AKEP, në gjykimin e Albtelecom është krejtësisht i pajustificuar dhe i papranueshëm, dhe siç e theksuam edhe më lart, vetëm sa redukton të ardhurat e operatorëve dhe nuk shërben për asnjë përfitim tjetër në tregun e komunikimeve elektronike.

Gjithashtu, në lidhje me kalimin me 2 Pika Interkoneksioni, (normuar në Analizën dhe Vendimet e mëparshme të AKEP), tashmë Albtelecom ka fasiluar ndjeshëm operatorët që me reduktimin me rreth 70% të pagesave për qarqet 2 mbps (rreth dy vjet me parë) si dhe në mënyrë specifike, për vijimin e qarqeve 2 mbps të operatorëve nga rajonet ku janë lidhur përkatësisht deri tek Pika e Interkoneksionit Durrës, po aplikon konceptin e “distancës gjeografike” në vend të gjatësisë fizike të qarkut 2 mbps duke reduktuar gjatësinë e tarifueshme, dhe ku me aplikimin edhe të koeficientit të trafikut, reduktohen akoma më ndjeshëm pagesat përkatëse të shërbimeve të lidhjes deri në Pikën e Interkoneksionit Durrës (apo qoftë edhe Tiranë).

Prandaj, ky fasilim që i është bërë operatorëve, është akoma më tepër një argument shtesë që mbështet kërkesën tonë për rritje të tarifës së terminimit dhe të tranzitimit të paktën deri në analizën tjetër të radhës të tregut të telefonisë fikse.

## **Sqarim i AKEP**

Lidhur me pretendimet e Albtelecom, AKEP e falenderon për komentet dhe sqaron se për çështjen e rregullimit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse, bazuar në parashikimet e ligjit 9918 “Për komunikimet elektronike në RSH” AKEP do të zhvillojë një këshill publik të veçantë ku do të diskutohen edhe këto pretendime.

### III. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik

Kjo pjesë përmban komente e palëve të interesuara të grupuara sipas pyetjeve të këshillimit public dhe qëndrimi i AKEP për komentet për cdo pyetje.

#### 1. A ka pasqyruar drejt AKEP zhvillimet në tregun me pakicë të shërbimeve të telefonisë fikse?

##### Telekom Albania

Telekom Albania vlerëson se zhvillimet e pasqyruara në këtë analizë të telefonisë fikse nga ana e AKEP reflektojnë në vija të përgjithshme dinamikat e këtij tregu.

Telekom Albania është e mendimit që konkurrenca në tregun me pakicë të telefonisë fikse vijon të shfaq ende probleme në këtë treg krahasuar me situatën në vendet e tjera të rajonit apo dhe të BE, për shkak të penetrimit mjaft të ulët të saj në të gjithë vendin si dhe të diferencave në mbulimin e territorit me rrjet fikse midis operatorit fikse inkumbent dhe operatorëve të tjerë.

**Sqarim i AKEP:** AKEP e falenderon sipërmarrësin Telekom Albania për komentet dhe shprehet dakort sa i takon faktit që penetrimi dhe mbulimi me rrjete fikse mbetet në nivele të ulta.

##### Vodafone Albania

VA nuk është dakord me konkluzionet e AKEP, të cilat të krijojnë përshtypjen se tregu i telefonisë fikse ka përmirësim të dukshëm në nivel konkurrence, ndërkohë që shifrat tregojnë të kundërtën. Operatori Altelecom vazhdon të dominojë haptazi në formë monopolistike me tregun e pajtimtarëve të telefonisë fikse në nivelin 71% si dhe në tregun e thirrjeve telefonike në nivelin 87%. Rrjedhimisht, operatorit inkumbent dominon dhe në të ardhura, ndërkohë që operatorët e tjerë e kanë të pamundur për të mposhtur hegjemoninë e tij.

VA është e mendimit se suksesi në tregun me pakicë varet, ndërmjet të tjerash, nga ndërhyrja rregullatore në tregun me shumicë, në mënyrë të tillë që edhe të nxitë investimet dhe të garantojë ndërveprueshmërinë për të eliminuar riskun e biznesit. Prandaj, një treg pakicë dinamik sigurohet mbi bazën e një tregu me shumicë që funksionon si duhet dhe rregullohet sipas nevojës. Rregullimi ex-ante i vendosur në nivel shumice duhet të jetë i mjaftueshëm për të adresuar problemet potenciale të konkurrencës në tregun e lidhur më poshtë me pakicë (*doënstream*). Sidoqoftë, nëse ndërhyrjet në tregun me shumicë kanë rezultuar jo të suksesshme, atëherë duhet të zbatohet testi i tre kritereve.



**Sqarim i AKEP:** AKEP e falenderon sipërmarrësin Vodafone Albania dhe lidhur me sqaron se tregu i telefonisë fikse nuk ka zhvillimin dhe penetrimin e tregut mobile, zëvendësueshmëria e njëanshme e tregut të shërbimeve të fiksit nga ana e shërbimeve mobile (e anasjellta mobile me fiks s'është zëvendësim i plotë), numri relativisht i konsiderueshëm i hyrjeve në treg (mbi 80 operatorë) dhe ka rritje të konkurrencës ndaj operatorit *incumbent* Albtelecom i cili ka numrin më të madh të abonentëve port-out dhe madje nuk është as konkurrenti kryesor në disa rajone.

Përsa i takon komentit të Vodafone Albania për mosdakordësim me konkluzione e AKEP për ecurinë e zhvillimit të tregut me pakicë të telefonisë fikse, AKEP në këtë dokument ka analizuar zhvillimet dhe ecurinë e pjesëve të tregut të operatorëve pjesëmarrës, dhe pamvarësisht faktit se Albtelecom është operatori me pjesën më të madhe të tregut, siç është evidentuar edhe në analizë ky treg ka pasur rritje të konkurrencës, ku operatorët alternativë kanë shënuar rritje të numrit të pjesëve të tregut përsa i përket numrit të përdoruesve.

Për pjesën tjetër të komenteve lidhur me parimet e përgjithshme të rregullimit në tregjet e rrjedhjes së sipërme apo të poshtme të tregut AKEP ndan të njëjtin qëndrim me Vodafone.

### Albtelecom

Lidhur me të dhënat e paraqitura nga AKEP për tregun me pakicë të telefonisë fikse, mendojmë se trajtimi mbi zhvillimet në këtë treg është i drejtë dhe i duhur ku evidentohet përkeqësimi i treguesve të tregut të telefonisë fikse. Kështu, është e rëndësishme të theksojmë se në tendencën në ulje apo përkeqësimin vit pas viti të treguesve kryesorë të tregut të telefonisë fikse kanë luajtur rol parësor 2 faktorë të rëndësishëm:

- Thellimi i efektit të zëvendësimit të thirrjeve të telefonisë fikse me thirrje nga rrjetet celulare, ç'ka duket qartë në reduktimin me 21% të thirrjeve kombëtare të pajtimtarëve të Albtelecom për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 (sipas të dhënave të raportuara AKEP-it për 2017); apo në reduktimin me 19% të thirrjeve të Operatorëve Alternativë kundrejt Albtelecom për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016;
- Përdorimi në rritje i aplikacioneve të internetit për thirrjet telefonike, duke çuar kështu në reduktimin drastik të thirrjeve hyrëse në rrjetin e Albtelecom, reduktim ky i cili vetëm për thirrjet ndërkombëtare arriti në 35% krahasuar me vitin 2016 (reduktimi për vitin 2016 dhe vitin 2015 me vitet paraardhëse për të njëjtin zë ka qënë 29%).

Të dy këta faktorë bëjnë që përdorimi i telefonisë fikse të zbehet çdo ditë e më shumë, për rrjedhojë:

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse të Albtelecom është në ulje, duke u reduktuar konkretisht me 3% për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016. Përdorimi mesatar mujor për abonentë AMOU (thirrje dalëse/hyrëse) është ulur në mënyrë sinjifikative me më shumë se 40% krahasuar me vitin 2014, duke zbritur në 53 thirrje dalëse dhe 82 thirrje hyrëse në muaj për abonentë për vitin 2017.

### Qëndrimi i AKEP



AKEP vlerëson komentet e paraqitura lidhur zhvillimet në tregun me pakicë të shërbimeve të telefonisë fikse. Gjithashtu, në analizë vërehet se pjesa e tregut lidhur me treguesin e të ardhurave për operatorin Albtelecom, ka pësuar rënie të ndjeshme gjatë viteve 2015-2016 krahasuar me periudhat paraardhëse, duke rezultuar në rritje të pjesëve të tregut për operatorët alternativë.

AKEP gjithashtu është në fazën evidentimit të sipërmarrësve që nuk ofrojnë informacionet statistikore sipas kërkesave ligjore dhe është në fazën e marrjes së masave administrative ndaj tyre deri në revokimin e të drejtës së përdorimit të frekuencave.

## 2. Çfarë mendoni për konkluzionin e AKEP se nuk është e nevojshme që tregjet me pakicë të telefonisë fikse të jenë objekt rregullimi ex-ante?

### Telekom Albania

Siç u theksua në lidhje me zhvillimet e tregut me pakicë të telefonisë fikse, ky treg është karakterizuar nga ndryshime që kanë çuar në një rënie të ndjeshme të çmimeve të shërbimeve të ofruara.

Pavarësisht këtyre dinamikave, tregu retail në telefoninë fikse në vendin tonë është akoma shumë larg atij të vendeve të tjera të rajonit apo të BE-së për shkak të normës së ulët të penetrimit të telefonisë fikse si dhe për shkak të faktit që shumë operatorë alternativë fikse edhe pse kanë kryer investime të rëndësishme në ndërtimin e rrjeteve të tyre janë të shtrirë kryesisht vetëm në disa qendra të mëdha urbane apo në nivel lokal duke lënë të pambuluar me sinjal zona të tjera të territorit.

Për rrjedhojë operatori inkumbent gëzon ende avantazhe të konsiderueshme për shkak të prezencës më të madhe me rrjet në territor dhe të aksesit që ka në elementët esencialë të rrjetit dhe për pasojë nga kjo mund të rrjedhin sjellje abuzive kundrejt konkurrenteve të tjerë në treg. Një tjetër avantazh është dhe ofrimi i paketave të integruara fikse dhe celulare nga operatori Albtelecom, duke shfrytëzuar fuqinë e lartë konkurruese kundrejt operatorëve të tjerë fikse pasi gëzon mundësinë që të shfrytëzojë njëkohësisht pozitat e tij si operator në të dy tregjet, atë celular dhe atë fikse.

Gjithashtu, dhe në terma të ecurisë së pjesëve të tregut fikse, vihet re se Albtelecom zotëron akoma pjesë të larta të tij në nivel pajtimtarësh, thirrjeve telefonike apo dhe të ardhurave siç evidentohet dhe në tabelën e mëposhtme:

Tabela III.3 Ecuria e Pjesëve të tregut Albtelecom 2008-2016

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Pajtimtarë telefoni</b>	87%	87%	84%	76%	74%	75%	74%	72%	71%
<b>Thirrje telefonike dalëse</b>	93%	91%	94%	92%	89%	80%	86%	77%	87%
<b>Të ardhura totale nga rrjet fiks</b>	79%	78%	71%	74%	79%	72%	65%	60%	60%

Gjithashtu, vlen të theksohet se përfundimi i AKEP që tregjet e telefonisë fikse të mos jenë objekt rregullimi ex-ante bie në kundërshtim dhe me rregulloren që ka miratuar vetë AKEP, pasi tregu me pakicë i aksesit nga vendndodhje fikse për klientët familjarë dhe jo familjarë është në listën e 7 tregjeve nën rregullim dhe për ta hequr këtë treg nga kjo listë praktika që AKEP duhet të kishte kryer ishte ajo e konsultimit publik të rregullores aktuale për analizën e tregut për rishikimin e kësaj liste, përpara se të ndërmerre kryerjen e analizës së tregut dhe propozimit për të vendosur de-rregullimin e këtij tregu.

Siç është përmendur dhe në konsultimin e mëparshëm publik të vitit 2015, lidhur me testin e tre kritereve, edhe pse dy kriteret e tjera nuk plotësoheshin, kriteri i parë në lidhje me prezencën e barrierave të larta dhe jo kalimtare të hyrjes plotësohet për shkak se barrierat e hyrjes për shume operatorë vazhdojnë të jenë të larta, pasi investimet në rrjet janë të konsiderueshme dhe jo të gjithë operatorët mund t'i përballojnë dhe rekuperojnë ato për ndërtimin e rrjeteve të tyre. Ndërsa zëvendësueshmëria midis shërbimeve fiks-celulare nuk luan ndonjë rol në këtë drejtim pasi këto dy shërbime janë komplementare dhe jo zëvendësuese për shkak të karakteristikave funksionale të ndryshme nga njëra-tjetra duke mos qenë pjesë e të njëjtit treg.

Për më tepër, mbizotëron ende roli dominant i Altelecom duke iu referuar pjesëve të larta të tregut që ende zotëron (71% të pajtimtarëve, 87% në terma të thirrjeve dhe 60% në terma të të ardhurave gjatë vitit 2016).

Po ashtu, AKEP nga ana tjetër ka vënë tashmë nën rregullim që nga Korriku i vitit 2015 tregun me pakicë të telefonisë së lëvizshme, i cili ndërkohë nuk është në listën e tregjeve nën rregullim të Rregullores Nr. 9, datë 17.07.2009, "Për analizën e tregut". Pra, në këtë mënyrë kemi dy standarte të ndryshme, në njërin treg me pakicë AKEP gjykon të ketë de-rregullim të plotë të nje tregu që është në listën e tregjeve të rregulluara, dhe në tjetrin ka vendosur rregullimin e tij, duke qenë në këtë mënyrë në kontradiktë dhe jo koherent me pozicionet e ndërmarrja në tregjet me pakicë, si dhe në kundërshtim me rregulloren për analizën e tregjeve, i cili është një akt rregullator i nxjerrë prej vetë AKEP, në të cilin ai përcakton listën e tregjeve që duhet të jenë nën rregullim.

Pra, Telekom Albania vijon të mbetet e mendimit, se duke qenë se kriteri i parë i testit të tre kritereve plotësohet, që tregu me pakicë nga vendndodhje fikse të jetë akoma nën rregullimin ex-ante, dhe si i tillë duhet të vazhdojë të jetë në listën e tregjeve nën rregullim siç dhe parashikohet nga Rregullorja për analizën e tregjeve.

### **Sqarim i AKEP:**

Lidhur me komentet e sipërmarrësit Telekom Albania AKEP sqaron se AKEP vepron gjithmonë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe transparencës dhe se analizat e tregut zhvillohen sipas parashikimeve të nenit 34 të ligjit "Për komunikimet elektronike në RSH". Në dokumentin për këshillim publik të analizës së tregjeve përkatëse me shumice të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse, AKEP ka konkluduar .

Sipas dokumentit është konkluduar se sipërmarrësi Albtelekom ka pozitë dominuese në të dyja tregjet përkatëse dhe për këtë arsye janë propozuar masat rregullatore të parashikuara në nenet 39 e në vijim të Ligjit.

Sipas nenit 3.1. të rregullores së Analizës së Tregjeve<sup>20</sup>, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme **si tregje të mundshme** për ndërhyrje ex-ante në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, ndër të tjera, edhe (1) Tregun me pakicë të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse për klientet familjare dhe jo-familjare.

Pra lista përmban tregje të mundshme për ndërhyrje ex-ante por sipas nenit 3.2 të Rregullores **AKEP mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera** që nuk janë pjesë e listës dhe i realizon analizat e tregjeve në përputhje me dinamikën e zhvillimeve për të analizuar ekzistencën ose jo të konkurrencës efektive në tregjet përkatëse.

AKEP në analizat e mëparshme ka përdorur si referencë listën e tregjeve përkatës të rekomandimeve të viteve 2003 dhe 2007 të KE. Në rekomandimin e vitit 2014 për tregjet përkatës KE ka hequr nga lista e tregjeve për ndërhyrje ex-ante edhe tregun me pakicë të aksesit në rrjet fikse (i vetmi i ngelur nga lista e vitit 2007).

Ndërkohë sa i përket krahasimit me analizën ex-ante të tregut të pakicës në shërbimet e rrjeteve celulare AKEP sqaron se dinamikat e zhvillimit të atij tregu<sup>21</sup> në kushtet e daljes nga tregu të operatorit Plus Communication, ulja nga 4 në 3 operatorë efektivë në treg, barrierat e larta të hyrjes dhe një sërë faktorësh të tjerë që kanë ngutësuar strukturën e tregut celular dhe e bëjnë shumë të ndryshëm nga dinamikat e tregut fikse.

Nga të dhënat statistikore gjatë viteve të marra në analizë shihet qartë se pjesët e tregut të incumbent-it në shërbimet fikse janë luhatur dukshëm, operatorët alternativë në numër shumë më të lartë (66) kanë rritur presionin konkurrues ndaj operatori kryesor duke zbehur pozicionin e Albtelecom si dhe duke ofruar akses dhe tarifa ose paketa konkurruese.

Lidhur me testin e tre kritereve sqarojmë se pika 4 e nenit 31 të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH”, parashikon detyrimin për një rregullore për analizën e tregjeve dhe përcaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, datë 17.07.2009, ndryshuar me Vendimin nr.2342, datë 31.07.2013 ka miratuar Rregulloren për Analizën e Tregjeve (në vijim referuar si Rregullorja). Rregullorja e AKEP “Për analizën e tregut” është e përafuar me rekomandimin e Komisionit Evropian të datës 9 tetor 2014 mbi tregjet e produkteve/shërbimeve për rregullimin ex-ante, në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Evropian përcakton se autoritete rregullatore të vendeve antare duhet të demostrojnë dhe Komisioni do të verifikojë plotësimin e tre kritereve kumulative:

- (a) Prezencën e barrierave të mëdha dhe jo tranzitore, si barrierat strukturore, ligjore dhe rregullatore për hyrjen në treg;
- (b) Një strukturë tregu që nuk tenton drejt konkurrencës efektive;

<sup>20</sup> RREGULLORE NR. 9, DATË 17.07.2009 “PËR ANALIZËN E TREGUT” (MIRATUAR ME VKD NR.747, DATE 17.07.2009, NDRYSHUAR ME VKD NR.2342, DATE 31.07.2013)

<sup>21</sup>

<https://www.akep.al/images/stories/AKEP/publikime/2018/Analiza%20e%20tregut%20celular%20me%20Opakice%20tregjet%20me%20shumice%20akses%20origjin%20dhe%20terminimi%20nderkombetare%20Keshillim%20Publik.docx.pdf>

(c) Ligji konkurrencës, i vetëm, është i pamjaftueshëm për të adresuar dështimet e tregut.

AKEP sqaron se kriteri kumulativ i tre testeve nëkupton plotësimin e tyre në të njëjtën kohë dhe për këtë arsye është e qartë se plotësimi i vetëm një kriteri siç shprehet Telekom Albania në komentet e konsultimit publik, është i pamjaftueshëm për analizën ex-ante të tregut të pakicës në tregun përkatës të shërbimeve fikse.

### **Vodafone Albania**

VA gjykon se në parim tregjet e nivelit të pakicës nuk duhet të pësojnë ndërhyrje rregullatore. Siç u përmend dhe më sipër dhe sipas kërkesave të Rekomandimit të Komisionit European 2014/710/EU, një treg pakice duhet të rregullohet në mënyrë indirekte nëpërmjet rregullimit të tregut me shumicë. Pra, nëse tregu i pakicës në fjalë nuk ka konkurrencë efektive në perspektivë në mungesë të rregullimit ex-ante, tregu korrespondues me shumicë duhet të jetë objekt rregullimi ex ante sipas parashikimeve të Direktivës së BE 2002/21/EC. Nga ana tjetër, nëse tregu me pakicë ka konkurrencë efektive në perspektivë në mungesë të rregullimit ex-ante në tregun përkatës korrespondues, kjo duhet ta çojë rregullatorin në përfundimin se rregullimi nuk është më i nevojshëm në nivel shumice. Në këtë rast, tregu përkatës me shumicë duhet të vlerësohet duke konsideruar heqjen e rregullimit ex-ante.

Pavarësisht sa më sipër, AKEP është duke konsideruar në analizën e tregut të shërbimeve celulare nëse tregu i shërbimeve celulare me pakicë përmbush testin e tre kritereve (*ky qëndrim na duket absurd duke qenë se tregu i shërbimeve celulare me pakicë është tepër konkurrues dhe nuk është pjesë e listës së tregjeve për rregullim ex-ante as në Rekomandimin e Komisionit European, as në Rregulloren e AKEP*), ndërsa në tregun me pakicë të telefonisë fikse AKEP nuk e merr parasysh testin e tre kritereve.

Sipas parashikimit të Rekomandimit të BE 2014/710/EU, nëse AKEP gjen se ndërhyrja në tregun me shumicë ka qenë pa sukses, atëherë tregu përkatës me pakicë mund të bëhet objekt i zbatimit të masave ex-ante me kusht që të plotësohet testi i tre kritereve.

Në situatën aktuale ku ndodhet tregu me pakicë pa konkurrencë efektive si pasojë e dinamikave të ulëta të tregut dhe mungesës së ndryshimit në pjesët e tregut për operatorin incumbent, VA është e mendimit se testi i tre kritereve plotësohet. Ky konkluzion mbështetet nga fakti se së pari, barrierat për hyrjen në treg janë të dukshme dhe deri tani asnjë lojtar tjetër nuk ka hyrë në treg dhe nuk ka asnjë marrëveshje që të indikojë se ka ndonjë lojtar (konkret apo potencial) që po konsideron hyrjen në treg. Arsyja kryesore që barrierat e larta dhe të pakalueshme janë ende ekzistente është se infrastruktura fizike nuk mund të dublikohet lehtësisht dhe se ka kosto të larta për hyrjen në treg.

Detyrimet ex-ante kundrejt Albtelecom do të garantonin se operatorët alternativë mund të aksesojnë rrjetin e inkumbentit dhe të ofrojnë shërbime të telefonisë fikse duke përdorur modele biznesi alternative. Këto opsione biznesi i mundësojnë hyrësve të rinj të shmangin kostot e larta në lidhje me shtrirjen e rrjeteve fikse. Se dyti, siç u përmend edhe

më sipër nuk ka konkurrencë efektive siç tregohet nga shifrat dhe strukturat e tregut. Së treti, është e dukshme se ligji për konkurrencën dhe Autoriteti i Konkurrencës, pavarësisht ndërhyrjeve të tij janë të pamjaftueshëm për të trajtuar si duhet mungesën e konkurrencës efektive në tregun me pakicë.

### **Sqarimet e AKEP:**

AKEP është në përgjithësi dakort me konsideratat në parim të shprehura nga sipërmarrësi Vodafone për rregullimin e tregjeve të shumicës dhe/ose pakicës sipas rrethanave respective të konkurrencës efektive në tregjet përkatëse.

Ashtu siç është sqaruar edhe më lart në përgjigje të komenteve të sipërmarrësit Telekom Albania, AKEP ka analizuar tregjet mbi bazën e dinamikës së zhvillimit, strukturës, ekzistencës së një ose disa sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg dhe në lidhjen shkaktuese, pra pasi është provuar ekzistenca e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë sipas nenit 34 të Ligjit vendosen një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.

Sa i përket krahasimit me analizën ex-ante të tregut të pakicës në shërbimet e rrjeteve celulare AKEP sqaron se dinamikat e zhvillimit të atij tregu<sup>22</sup> në kushtet e daljes nga tregu të operatorit Plus Communication, ulja nga 4 në 3 operatorë efektivë në treg, barrierat e larta të hyrjes dhe një sërë faktorësh të tjerë që kanë ngutësuar strukturën e tregut celular dhe e bëjnë shumë të ndryshëm nga dinamikat e tregut fikse.

Ndërkohë të dhënat statistikore gjatë viteve të marra në analizë shihet qartë se pjesët e tregut të incumbent-it në shërbimet fikse janë luhatur dukshëm, operatorët alternativë në numër shumë më të lartë (66) kanë rritur presionin konkurrues ndaj operatorit kryesor duke zbehur pozicionin e Altelecom, sidomos në disa tregje gjeografike ku operatorët alternativë kanë qenë shumë agresivë në drejtim të rritjes së numrit të abonetëve për shërbimet fikse voice dhe broadband, si dhe duke ofruar akses dhe tarifa ose paketa konkurruese.

Sa i përket propozimeve të Vodafone Albania për vendosjen e detyrimeve të aksesit për Altelecom sqarojmë se në konkluzionet e dokumentit janë shprehur qartë konkluzionet se AKEP vlereson se sipërmarrësi Altelecom sh.a përmbush kushtet për t'u shpallur me FNT në tregjet përkatëse të mëposhtme:

- *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik Altelecom të ofruar nga vendndodhje fikse;*
- *Tregu me shumicë i shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse.*

AKEP ka propozuar që për FNT të Altelecom për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtare të ruajë detyrimet aktuale rregullatore të përcaktuara edhe në analizë 2015:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
- Detyrimi i transparencës (Neni 40);
- **Detyrimi për akses dhe interkoneksion** dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);

---

22

<https://www.akep.al/images/stories/AKEP/publikime/2018/Analiza%20e%20tregut%20celular%20tregu%20me%20Opakice%20tregjet%20me%20shumice%20akses%20origjin%20dhe%20terminimi%20nderkombetare%20Keshillim%20Publik.docx.pdf>

- [Detyrimi për kontroll të tarifave \(Neni 45\).](#)

### Albtelecom

Duke marrë në konsideratë për sa shtjelluam edhe më sipër dhe konkretisht të gjithë faktorët e mëposhtëm të analizuar dhe të paraqitur edhe në dokumentin e analizës, të tillë si:

- Ecurinë në numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse (rënien e tyre vit pas viti);
- Reduktimin e konsiderueshëm të trafikut telefonik të pajtimtarëve për thirrjet nga/drejt rrjeteve fikse apo për thirrjet nga/drejt destinacioneve ndërkombëtare, veçanërisht në 2 vitet e fundit;
- Tarifimin e shërbimeve me pakicë nga rrjeti fiks, ku vlen të theksojmë se thirrjet kombëtare janë kryesisht të ofruara brenda pagesës fikse mujore që pajtimtari kryen për paketën e integruar (2P/3P) të zgjedhur prej tij;
- Reduktimin me rreth 40% në përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike (hyrëse/dalëse) nga rrjeti fiks i Albtelecom (AMOUI, për vitin 2017 krahasuar me vitin 2014);
- Pjesët e tregut të Albtelecom sipas pajtimtarëve, apo të ardhurave nga rrjeti fiks i tij, të cilat vijnë në ulje;

atëhere, Albtelecom mbështet konkluzionin e AKEP, se nuk është e nevojshme që tregjet me pakicë të telefonisë fikse të jenë objekt rregullimi ex-ante, sa kohë që bazuar dhe në faktorët e renditur më sipër tregu i telefonisë fikse duket lehtësisht që është në konkurrencë edhe me efektive se në Vitin 2015 (analiza më e fundit e tregut).

### Qëndrimi i AKEP

[AKEP vlerëson konstatimet e përgjithshme të Albtelekom mbi faktorët që përcaktojnë analizën ex-ante të tregjeve përkatëse.](#)

### **3. Çfarë mendoni në lidhje me ecurinë e pjesëve të tregut të Albtelecom?**

#### Telekom Albania

Bazuar në evidencat e pjesëve të tregut për Albtelecom në këtë analizë tregu, edhe pse në vite është vënë re një rënie graduale gjatë periudhës 2008-2016, përsëri këto pjesë tregu janë ende të larta. Pra, kemi të bëjmë me një pozicion dominant të Albtelecom në tregun me pakicë të telefonisë fikse kundrejt operatorëve të tjerë, me një diferencë të konsiderueshme në raport me pjesët e tregut të operatorëve të tjerë, duke pasur këtu parasysh dhe numrin e lartë të tyre aktiv në treg.

Një panoramë e tillë nënkupton që Albtelecom gëzon avantazhe të konsiderueshme krahasuar me operatorët e tjerë, edhe pse tregu i telefonisë fikse ka shfaqur një tendencë rritjeje të konkurrencës, reflektuar kjo me çmimet gjithnjë e në rënie të shërbimeve, por që është ndikuar në mënyrë të konsiderueshme edhe nga përdorimi i lartë i shërbimeve celulare dhe rënia e interesit të abonentëve në përdorimin e shërbimeve fikse.



Telekom Albania gjykon se një nivel i tillë i lartë në pjesët e tregut për Albtelecom reflektohet në probleme të konkurrencës midis operatorëve, situatë e cila nënkupton se është ende i nevojshëm monitorimi dhe ndërhyrja rregullatore nga ana e AKEP.

### Vodafone Albania

Operatori Albtelecom vazhdon të dominojë haptazi në formë monopolistike me tregun e pajtimtarëve të telefonisë fikse në nivelin 71% si dhe në tregun e thirrjeve telefonike në nivelin 87%. Është e vërtetë që të ardhurat nga shërbimet e rrjetit fiks kanë pësuar një rënie me 15%, por kjo rënie nuk bazohet në argumenta konkurrueshmërie por në faktor të jashtëm si rënia e ndjeshme e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

### Albtelecom

Përsa i takon pjesëve të tregut të Albtelecom në terma të pajtimtarëve, dhe të të ardhurave, të cilat janë ulur vit pas viti (sic dhe është evidentuar në dokumentin e Analizës), mendojmë se këto tregues janë zhvillime të pritshme në një treg ku konkurrenca është efektive dhe e fortë.

E kundërta ndodh në tregun e telefonisë celulare, ku edhe në prani të disa detyrimeve dhe mekanizmave të vendosura nga AKEP (por për të gjithë operatorët në këtë treg), operatori kryesor i tij vijon të ketë rritje të pjesëve të tregut në të gjithë termat (përdorues telefonie, interneti, thirrje dalëse, sms, dhe të ardhura), duke tkurrur cdo ditë e më shumë dy operatorët e tjerë.

Përsa i takon pjesës së tregut të Albtelecom për thirrjet dalëse (kornbetare fikse/celulare, ndërkombëtare fikse/celulare), rritja e këtij treguesi është e shpjgueshme dhe e arsyeshme për shkak se:

- Duke synuar maksimalisht për të nxitur përdorimin e telefonisë fikse, përfshirja gjatë vitit 2016 në paketat e integruara të Albtelecom fiks edhe të thirrjeve drejt rrjetit celular të Albtelecom (sasi minutash e cila varion varësisht paketës së zgjedhur), kundrejt një pagese mujore fikse, ka arritur sadopak ruajtjen në të njëjtat nivele, të përdorimit nga pajtimtari i Albtelecom për kryerjen e thirrjeve dalëse drejt rrjetit celular pa reduktim të ndjeshëm sikurse drejt destinacioneve të tjerë. Pra, ka qenë dizenjimi i ofertave dhe paketave nga ana e Albtelecom që ka shërbyer për nxitjen e abonentit për kryerjen e thirrjeve dalëse dhe jo tarifa e terminimit në vetvete, ndaj dhe theksojmë se cdo reduktim i tarifës së terminimit në rrjetet fikse përkthehet vetëm në ulje të të ardhurave dhe rrjedhimisht të pamundësisë për investime të metejshme nga ana e Albtelecom duke shkaktuar kështu në finalev që reduktimi i tarifës së terminimit të mos shërbejë pozitivisht as për abonentin dhe as për operatorin.

Ndërkohë lidhur me tregun e tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse:

Mendojmë që nuk është trajtuar në menyrë të drejtë, pasi parashtrimi duke dhënë vetëm shifrat në përqindje japin idenë e dominimit në këtë treg, por nga ana tjetër shifrat në vlera reale të minutave të tranzituara dhe të të ardhurave të Altelecom nga ky shërbim janë shumë minimale, dhe pothuajse të papërfillshme nëse i referohemi numrit të madh të operatorëve që i shërbehet (mbi 40 operatore), përfshirë e këtu edhe operatorët celularë, kështu, të dhënat për 2016 tregojnë një sasi prej rreth 7.6 mln minuta në vit, dhe 14.25 min lekë të ardhura në vit (ose rreth 600 mijë minuta/muaj të tranzituar për mbi 40 operatorë dhe rreth 1.2 min lekë të ardhura/muaj), shifra këto jo potenciale, për më tepër ku një pjesë e mirë e operatorëve kanë shifra trafiku të papërfillshme tranziti. Vlerat e ulta të këtyre shifrave dhe në kushtet që ky shërbim garantohet prej kohësh nga ana e Altelecom bëjnë që operatorët alternativë të mos kenë interes për tu investuar në zgjidhje të tjera alternative në lidhje direkte ndërmjet tyre reciprokisht.


Pra, nuk është e vërtetë që ky treg ndodhet nën efektin e barrierave, pasi me të drejtën që jep ligji mbi neutralitetin teknologjik ekzistojnë mundësitë lehtësisht për sigurimin e lidhjeve ndërmjet vetë operatoreve, por për sa kohë që ky shërbim (shërbimi i tranzitit) është me kërkesë të ulët në treg dhe që sigurohet akoma me detyrim prej Altelecom, i rregulluar nga AKEP, kuptohet që asnjë nga operatorët alternativë nuk ka pse të investohet me kosto për të gjetur zgjidhje të tjera.

Prandaj, ne gjykojmë që duhet të konsiderohet heqja e masave rregulatore për tregun e tranzitimit me qëllim që të zhvillohen stimujt për rritjen e efikasitetit nga të gjithë operatorët lidhur me këtë treg.

### Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me këtë pyetje, palët që kanë paraqitur komentet mbështesin analizën e AKEP lidhur me ecuritë e pjesëve të tregut të operatorit Altelecom.

AKEP në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr.9918/2008 monitoron zhvillimet dinamike në tregjet e telefonisë fikse dhe me gjerë dhe në rastet kur është e nevojshme do të ndër marrë masa rregulatore përkatëse.





**4. A jeni dakort me përfundimet e AKEP për përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet individual fikse?**

**Telekom Albania**

Telekom Albania, në linjë dhe me komentet e shprehura dhe në konsultimet e tjera publike, është e mendimit që terminimi i thirrjeve në rrjetin e secilit operator alternativ fikse përbën një treg përkatës të veçantë, të identifikuar nga tregjet e tjerë me shumicë, për shkak të pamundësisë për të pasur akses në këtë treg nga ana e operatorëve të tjerë për të ofruar shërbimin përkatës të terminimit në rrjetin e çdo operatori alternativ fikse, si dhe të mungesës së alternativave të tjera zëvendësuese. Shërbimet e terminimit që ofrohen nga një operator alternativ fikse në rrjetin e tij nuk mund të zëvendësohen me shërbime të tjera alternative, fikse apo mobile po në këtë rrjet. Për më tepër, në nivelin me shumicë, nuk ekziston asnjë zëvendësim direkt fikse-mobile. Gjithashtu, tregu i terminimit nga vendndodhje fikse është i identifikuar dhe përkufizimin si i tillë në të gjitha rekomandimet e BE-së të vitit 2003, 2007 dhe 2014. E njëjta logjikë që është përdorur në përkufizimin e tregjeve të terminimit nga rrjetet mobile, shtrihet dhe në përkufizimin e tregut përkatës të terminimit nga një vendndodhje fikse për të gjithë operatorët e telefonisë fikse.

Vodafone Albania

Po. Operatori inkumbent ashtu si edhe çdo operator tjetër i telefonisë fikse është dominant për terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij. Ky është dhe qëndrimi i qartë i Rekomandimit të KE në vitin 2003, 2007 dhe 2014, të gjithë praktikantët e vendeve evropiane dhe të rajonit si edhe qëndrimi i AKEP i shprehur në Rregulloren për Analizën e tregut.

Albtelecom

Albtelecom është dakord me konkluzionet e AKEP për përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet individual fikse.

**Sqarim i AKEP:** Ashu si në rastet e analizave të tjera të tregjeve përkatëse nuk ka kontestime nga ana e operatorëve për përcaktimin e tregjeve përkatëse.

**5. A mendoni se të gjithë operatorët aktivë të rrjeteve telefonike publike fikse, përmbushin kriteret për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individualë?**

Telekom Albania

- Terminimi në rrjetin Albtelecom

Telekom Albania i qëndron pozicionit të saj të shprehur dhe në konsultimet e mëparshme publike, dhe mendon që Albtelecom i përmbush të gjitha kriteret për FNT në tregun e terminimit në rrjetin e tij, për shkak të karakteristikave që ka ky treg dhe mënyrës se si operohet në të.

- Terminimi në rrjetin e operatorëve alternativë dhe Telekom Fix

Operatorët alternativë përfshirë dhe Telekom Albania për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse janë shpallur si operatorë me FNT në tregjet përkatëse të terminimit që në vitin 2013, për të cilën Telekom Albania nuk ka qenë dakort me këtë përcaktim.

Siç jemi shprehur dhe në analizën e tregut fiks të 2013 dhe 2015, këta operatorë nuk i përmbushin kriteret për FNT në tregun e terminimit fiks. Këto kritere kanë të bëjnë me pozitën dominante të operatorit në një treg të caktuar, referuar Udhëzimit të Komisionit Europian për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT-së 2002/C 165/2003.

**Edhe pse operatorët alternativë së bashku me Telekom Fix tashmë kanë 100% pjesë të tregjeve përkatës të terminimit**, ata kanë një fuqi të ulët kundërvepruese në raport me operatorin inkumbent Albtelecom në ofrimin e shërbimit të terminimit, karakterizohen nga shtrirje me të kufizuar të rrjetit dhe nuk kanë avantazhet në aksesin e burimeve financiare që gëzon Albtelecom. Gjithashtu, Albtelecom zotëron pjesë mjaft të larta të tregut në terma të trafikut të thirrjeve dalëse në nivel 87% në vitin 2016 kundrejt konkurrentëve.

Për arsyet e mësipërme, Telekom Albania mbetet e mendimit që operatorët alternativë dhe Telekom FIX nuk i plotësojnë ende kushtet për të pasur status me FNT në tregjet e terminimit në rrjetet e tyre fikse.

### Vodafone Albania

Po. Çdo operator i telefonisë fikse është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve drejt abonentëve të vet. Duke mos pasur zëvendësueshmëri as në kërkesë as në ofertë për terminimin e thirrjeve në një rrjet specifik, çdo rrjet përbën një treg përkatës dhe çdo operator i atij rrjeti ka një pozicion monopolistik në tregun për terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij.

### Albtelecom

Po. Sikurse dhe AKEP ka analizuar në dokumentin e analizës për faktorët/kriteret e konsideruar me të rëndësishëm të tillë si, pjesët e tregut, fuqia kundërvepruese e blerësve të shërbimit dhe tarifimi i shërbimit të terminimit, secili nga Operatorët e tregut të telefonisë fikse është FNT në tregun e terminimit të thirrjeve. Sa kohë që secili nga operatorët e telefonisë fikse gëzon 100% pjesë tregu, sa kohë që kjo pjesë tregu nuk varet nga madhësia e rrjetit apo nga numri i pajtimtarëve, secili prej tyre është monopolist në këtë treg. Për më

tepër nuk ka asnjë mundësi teknike për terminimin e thirrjeve nga një rrjet në tjetrin pa ndërveprimin e operatorit, në pajtimtarin e të cilit terminohet thirrja.

#### Qëndrimi i AKEP

Operatorët janë dakort për përfundimin e AKEP për këto tregje, përveç Telekom Albania i cili shprehet se është dakord që operatori Altelecom të jetë me FNT, ndërsa Telekom Albania (fiks) dhe operatorët e tjerë alternativë nuk i plotësojnë ende kushtet për të pasur status me FNT në tregjet e terminimit në rrjetet e tyre fikse.

Në lidhje me pretendimin e Telekom Albania, AKEP ka dhënë argumenta të detajuar në dokumentin e analizës për këshillim dhe gjykon të drejtë përfundimet e arritura në të.

Vetëm telekom Albania pranon se ka 100% të tregjeve përkatës të terminimit. Pjesa e tregut të terminimit të thirrjeve drejt abonenteve të rrjetit nuk varet nga madhësia e rrjetit, pasi pavaresisht madhësisë apo numrit të pajtimareve në rrjet, secili operator është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve drejt aboneteve të vet.

Pjesa e tregut prej 100% që secili operator ka në terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij, nuk pritet të ndryshojë pasi nuk ka as alternative teknike për zëvendësimin e tij:

- ✓ Teknikisht nuk ka asnjë mundësi për terminimin e thirrjeve nga një rrjet A në një rrjet B pa ndërveprimin e operatorit që zoteron pajtimtarët drejt të cilëve është destinuar thirrja.
- ✓ Barrierat e natyrës teknike janë të paevitueshme për të mundësuar shërbimin e terminimit të një rrjeti tjetër në mungesë të koordinimit dhe gjetjes së një vije sjellje të përbashkët në negociatat që mund të zhvillohen.

## **6. Çfarë mendoni për masat rregullatore për terminimin në rrjetet fikse?**

### Telekom Albania

- Masat rregullatore për terminimin në rrjetin fikse të Altelecom

Për sa i përket masave rregullatore për Altelecom që të mbeten të pandryshuara nga AKEP, në lidhje me terminimin në rrjetin fikse të Altelecom (detyrimet për mosdiskriminim, për transparencë, për akses dhe interkoneksion, kontroll të tarifave si dhe publikim/përditësim të RIO-s dhe të marrëveshjeve të SLA), Telekom Albania shprehet dakort duke qenë se ky operator i plotëson kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij fikse dhe nuk ka ndonjë koment shtesë në lidhje me këtë pikë.

E njëjta gjë vlen gjithashtu dhe për tranzitimin e thirrjeve kombëtare në rrjetin fikse të Altelecom lidhur me detyrimet përkatëse të këtij operatori në këtë treg, siç janë përcaktuar nga AKEP në këtë analizë tregu.

- Masat rregullatore për terminimin në rrjetin fikse të Telekom Albania dhe operatorët alternativë

Lidhur me masat rregullatore (detyrimeve për transparencë, mosdiskriminim dhe dhënie akses për interkonkesion) në tregun e terminimit për operatorët alternativë dhe Telekom Albania, duke qenë se Telekom Albania i qëndron pozicionit të saj të shprehur dhe në konsultimin e mëparshëm publik të analizës së tregut fikse të 2015 se nuk i plotëson kriteret për të qenë me FNT në tregun e terminimit në rrjetet fikse.

Ndaj gjykon që lënia në fuqi e masave rregullatore nga ana e AKEP janë të tepërta dhe jo në përputhje me pozicionin që TA ka në tregun e terminimit fikse. Për këtë arsye, AKEP duhet të rishikojë mundësinë e heqjes së këtyre masave, pasi rezultojnë të panevojshme referuar situatës së operatorëve alternativë dhe TA në tregun e terminimit fikse të thirrjeve.

#### Sqarim i AKEP

AKEP gjykon se pretendimin e Telekom Albania e ka trajtuar gjerësisht në dokumentin për këshillim të kësaj analize dhe analizave të mëparshme. AKEP ka analizuar faktorët që ndikojnë në këtë treg, të cilat nuk kanë ndryshuar dhe nuk pritet të ndryshojnë në një të ardhme.

AKEP pasi ka provuar ekzistencën e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme (Telekom Albania sh.a. përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtareve të Telekom Albania Fiks), pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë sipas nenit 34 të Ligjit vendosen një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.

#### Vodafone Albania

VA është dakord me qëndrimin e AKEP lidhur me analizën e tregut të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e operatorit inkumbent, shpalljen FNT të tij, si dhe me masat rregullatore të propozuara nga AKEP për të.

Gjithashtu, VA i kërkon AKEP të monitorojë detyrimin për ndarjen e llogarive për produktet celulare dhe atë fikse që i janë kërkuar operatorit inkumbent nga Autoriteti i Konkurrencës sepse kjo mungesë monitorimi i jep Albtelcom mundësinë të zbatojë subvencion të tërthortë (cross-subsidy) midis dy tregjeve.

Gjithashtu, duhet të vendoset një masë rregullatore për ndarjen e llogarive midis tregjeve me shumicë dhe pakicë (upstream dhe downstream) pasi operatori inkumbent mund të zbatojë praktika të ngjeshjes së çmimit (margin squeeze) dhe çmimet nën kosto grabitqare (predatory pricing). VA mendon se mënyra e vetme për të monitoruar këtë sjellje është të vendosen masa ex-ante të tilla si marrja e miratimit të AKEP përpara hedhjes në treg të një produkti.

Sqarim i AKEP: Duke falenderuar sipërmarrësin Vodafone Albania për risjellje në vëmendje të problemit të subvencionit të tërthortë dhe zbatimin e praktikave të Margin Squeeze, AKEP po monitoron dhe analizon sjelljet e sipërmarrësve në të gjitha tregjet përkatëse, përfshirë shërbimet celulare dhe ato nga rrjetet fikse.

#### Albtelcom

Lidhur me masat rregullatore të propozuara nga AKEP, për operatorët e tregut të telefonisë fikse, për terminimin në rrjetet fikse, të tilla si: detyrimi për mosdiskriminim, transparencë,

akses dhe interkoneksion si dhe të kontrollit të tarifës, Albtelecom mirëkupton qasjen e AKEP. Megjithatë, Albtelecom gjykon se në rrethanat e zhvillimit të tregut të telefonisë fikse me tregues që vijnë vazhdimisht në rënie sic edhe është pasqyruar në dokumentin e Analizës së vet AKEP, dhe në rrethanat kur vetë operatorët janë të interesuar për të vendosur marrëdhënie interkoneksioni ndërmjet tyre, Albtelecom mendon se detyrimet e tjera rregullatore si detyrimi për mosdiskriminim, transparencë, akses dhe interkoneksion janë të panevojshme për Albtelecom sh.a. Megjithatë, nëse AKEP gjykon se këto detyrime duhet të vijojnë të mbeten, në cdo rast dhe në mënyre të padiferencuar të gjithë operatorët e telefonisë fikse duhet të jenë subjekt i këtyre detyrimeve.

Përsa i takon nivelit të tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP për Operatorët Alternativë, AMC Fiks dhe Albtelecom, dhe tarifës së tranzitimit të trafikut kombëtar të propozuar për Albtelecom, qëndrimi i Albtelecom është paraqitur që në hyrje të komenteve në pjesën e parë të tyre si dhe në përgjigje të pyetjes Nr.7.

#### Qëndrimi i AKEP

Operatorët janë dakord me përfundimet e AKEP në lidhje me vendosjen e masave rregullatore për terminimin në rrjetet fikse, me përjashtim të Telekom Albania, i cili në qëndrimin e tij kërkon zbatimin e këtyre masave vetëm nga operatori Albtelecom (i cilësuar me FNT) dhe jo nga operatorët alternativë. Si përfundim AKEP i qëndron mendimit që konkluzionet dhe arsyetimet e përdorura në dokumentin e analizës së konsultuar janë të drejta, parimore dhe plotësojnë kriteret e ligjit për AO dhe Telekom Albania fiks në këto tregje.

### **7. Cili është opinionimi juaj në lidhje me skemën e re të reduktimit të ftr të të gjitha rrjeteve fikse dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin albtelecom?**

#### Telekom Albania

Në dokumentin e analizës së tregut të telefonisë fikse për konsultim publik, miratuar me VKD nr.28, datë 27.12.2017, AKEP ka propozuar një skemë të re për reduktimin e tarifave të terminimit në të gjitha rrjetet fikse dhe të tranzitimit në rrjetin e Albtelecom, duke shtyrë me një vit afatin e reduktimit të tarifës së terminimit fiks nga 1.29 lekë/min në 0.7 lekë/min dhe të tranzitimit fiks në rrjetin e Albtelecom nga 0.81 lekë/min në 0.44 lekë/min. Tarifat e terminimit fiks 0.7 lekë/min dhe të tranzitimit fiks 0.44 lekë/min ishin parashikuar të hynin në fuqi me 1.01.2018 dhe propozohet të hyjnë në fuqi duke filluar nga data 1.01.2019, duke futur ndërkohë një fazë ndërmjetëse 1.09.2018-31.12.2018, në të cilën janë propozuar aplikimi i tarifës së terminimit 1 lekë/min dhe tranzitimit fiks (tranzitimit në rrjetin fiks të Albtelecom) 0.63 lekë/min. Kjo shtyrje përbën një rast unik dhe një mungesë koherence në kohë të pozicioneve të AKEP.

Ndërkohë me anë të vendimeve Nr. 2617-2620, datë 8.10.2015, dhe në vijim të shqyrtimit të ankimit administrativ të Albtelecom, me anë të disa ndryshimeve të këtyre vendimeve, AKEP përcaktoi që nga data 1.01.2018 do të fillonte aplikimi i tarifës së terminimit fiks 0.70 lekë/min për të gjithë rrjetet fikse dhe tarifa e tranzitimit 0.44 lekë/min në rrjetin fiks të Albtelecom, nuk kuptohen shkaqet apo rrethanat që e kanë çuar AKEP në këtë konsultim

publik të analizës së tregut në propozimin për shtyrjen e afatit të aplikimit të këtyre tarifave dhe futja e një periudhe ndërmjetëse 1.09.2018-31.12.2018 për aplikimin e FTR 1 lekë/min dhe të tarifës së tranzitit kombëtar 0.63 lekë/min në rrjetin e Albtelekom. Kjo ka një impakt financiar në planet e biznesit të operatorëve të tjerë dhe për Telekom Albania që kanë marrëdhënie direkte interkoneksioni me operatorin Albtelecom, të cilat janë hartuar bazuar në glide-pathin aktual që parashikon aplikimin e tarifave të reja (FTR 0.7 lekë/min dhe tarifa e tranzitimit 0.44 lekë/min), pasi me anë të skemës së re të propozuar do të rrisë kostot financiare të operatorëve, pasi përveç kostos së terminimit për trafikun e shkëmbyer direkt me Albtelecom, operatorët fiks dhe TA i paguajnë këtij të fundit dhe për trafikun kombëtar që tranzitohet nëpërmjet Albtelecom, duke qenë me FNT në tregun e tranzitimit kombëtar, dhe rritja e kostos së tranzitimit të operatorëve është një përfitim i drejtpërdrejtë financiar për Albtelecom. Tarifat e tranzitimit dhe të terminimit fiks që propozohen për t'u aplikuar gjatë fazës ndërmjetëse (1 lekë/min dhe 0.63 lekë/min) janë tërësisht abstrakte, dhe nuk është dhënë asnjë burim apo studim se si është arritur në përloagritjen e këtyre vlerave, dhe pse vlera e FTR 1 lekë/min është simetrike dhe e njëjtë për të gjithë operatorët e rrjeteve fikse.

Gjithashtu, këto tarifa nuk janë të mbështetura dhe të orientuara në kostot përkatëse për përlllogaritjet e tyre, siç shprehet qartësisht dhe në kuadrin rregullator, më saktësisht, në nenet 45, 49 dhe 57 të ligjit 9918 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku është theksuar në mënyrë të qartë kërkesa për zbatimin e parimit të orientimit në kosto dhe preferenca për ndërtimin e një modeli të saktë për kalkulimin e kostove në përcaktimin e tarifave të interkoneksionit. Për më tepër Albtelecom ka dhe detyrimin rregullator për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtare fikse, nëpërmjet të cilave ky operator përcakton kostot përkatëse të ofrimit të shërbimeve të terminimit dhe tranzitimit në rrjetin e tij fiks, informacion ky që duhet të shërbejë si bazë për AKEP për llogaritjen dhe aplikimin e tarifave përkatëse për Albtelecom.

Pra, në përcaktimin e tarifave përkatëse të interkoneksionit si pjesë e detyrimit të kontrollit të tarifave, AKEP duhet të veprojë bazuar mbi këto parime në kuadër të përcaktimit dhe rregullimit të tregjeve të justifikueshme për nderhyrje ex-ante. TA ka përmendur dhe më parë se tarifat e terminimit të bazuara në metodologjinë benchmark sipas tarifave mesatare me LRIC të pastër të vendeve të BE-se nuk i reflektojnë kostot përkatëse efektive që operatorët manifestojnë realisht në treg. AKEP-it i është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme aplikimi i një metodologjie për përlllogaritjen e kostove përkatëse të interkoneksionit për të pasur një reduktim të tarifave të orientuara në kostot reale të operatorëve, gjë e cila nuk është marrë parasysh nga AKEP si në raundet e mëparshme të analizave të tregut ashtu edhe në këtë analizë tregu.

Për këto arsye, Telekom Albania nuk është dakort me propozimin e AKEP lidhur me këtë skemë të re të reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe tranzitimit në rrjetin fiks të Albtelecom lidhur me shtyrjen e afatit të aplikimit të këtyre tarifave, dhe gjykon që afati i aplikimit të tyre të vijojë të mbetet 1.01.2018, siç është në skemën aktuale për tarifat e interkoneksionit për rrjetet fikse.



Gjithashtu, TA shpreh sërish të njëjtin objeksion se është i nevojshëm implementimi i një modeli kostosh për të pasur tarifa të bazuara në kosto të sakta që manifestojnë operatorët, pasi vlerat e propozuara nuk reflektojnë realisht kostot përkatëse që Albtelecom ka.

Të njëjtin objeksion TA shpreh dhe në lidhje me përdorimin e metodologjisë benchmark për rregullimin e tarifave të terminimit edhe në rrjetet e telefonisë fikse si për operatorët alternativë ashtu dhe për Telekom Fiks.

Gjithashtu, Telekom Albania vijon të mbajë të njëjtin pozicion që nuk i përmbush kushtet për FNT në tregun e terminimit fikse, dhe siç jemi shprehur dhe në konsultimet e mëparshme publike për tregun fikse, tarifat e terminimit duhet të jenë të një natyre rekomanduese.

### Vodafone Albania

Në parim VA gjykon se uljet e forta dhe të menjëhershme të tarifës së terminimit nuk i shërben qëllimit të rregullimit dhe përbën rrezik për qëndrueshmërinë financiare duke ndikuar negativisht në nivel investimesh. Kjo qasje duhet të aplikohet gjithmonë nëpër analiza ku rishikohen tarifat e terminimit dhe VA e ka mbështetur si në tregun e terminimit të telefonisë së levizshme dhe atë fikse. Thënë kjo, glide-path i propozuar nga AKEP duhet të reflektojë me korrektësi dhe barazi realitetin e ofruar nga praktikrat evropiane, kostot që mbartin operatorët fikse përkundëjt atyre celularë dhe në këtë mënyrë të garantojë mosdiskriminim krahasuar me benchmark-un e aplikuar ndaj operatorëve celularë. Kjo gjë sigurohet duke ndjekur praktikrat dhe direktivat Evropiane në lidhje me metodologjitë e aplikuar nga shtetet anëtare të BE-së për llogaritjen e tarifave të terminimit.


Siç është parashikuar edhe në raportin e 7 Dhejtorit, 2017 BoR (17) 227, të BEREC dhe sipas Rekomandimit të Komisionit Europian 2009/396/EC, datë 7 Maj 2009, "mbi Trajtimin Rregullator të Tarifave të Terminimit Fiks dhe Mobile në Vendet Anëtare të BE" ("Rekomandimi"), entet rregullatore duhet të përcaktojnë tarifa terminimi bazuar në kostot që një operator eficient pëson. Po sipas këtij raporti vetëm 6 nga entet raportuese përdorin benchmarking në përcaktimin e tarifave (pra jo sipas rekomandimit), por 5 nga këto përdorin Benchmarking bazuar në Pure BULRIC dhe vetëm Shqipëria përdor referencë vetëm Benchmark. Gjithashtu, raporti i fundit i Cullen International, "Tarifat e terminimit fikse dhe modeli kostove-operatorët inkumbent" parashikon se për shtetet anëtare që përdorin Pure LRIC FTR, mesatarja është 0.09 Eurocent/min, ndërsa mesatarja e thjeshtë aritmetike e 27 shteteve anëtare (përfshirë Finlandën), është 0,13 eurocent/min.

Në këtë kuptim, niveli i FTR mbetet ende tepër i lartë krahasuar me kostot e operatorit eficient sipas metodologjisë pure LRIC, si dhe krahasuar me tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, të cilat janë orientuar në kostot e operatorit eficient sipas metodologjisë pure LRIC, çka është në kundërshtim me praktikën e vendeve të BE, si më lart përmendur, ku raporti FTR/MTR është në nivelin mesatar 1:5 në favor të MTR.

Nga statistikatat e BE rezulton se nivelet e MTR gjithkund janë ndjeshëm më të larta se nivelet e FTR, në një mesatare prej 5 herësh. Më konkretisht, grafiku në vijim pasqyron diferencat midis FTR dhe MTR për shtetet e BE, bazuar në informacionin ofruar nga Cullen International (FTR është llogaritur për një thirrje mesatare lokale ku tarifa për thirrje i referohet një thirrjeje prej 3 minutash). Bazuar në këtë referencë, VA vlerëson se niveli i FTR i propozuar nga AKEP mbetet ende në nivele shumë të larta krahasuar me MTR, të cilat AKEP po i çon në kosto sipas modelit benchmark pure LRIC dhe një glide-path-i tepër të

mprehtë. Në këtë kontekst, VA sugjeron që FTR duhet të synojë qasjen e shpejtë në mesataren e benchmarkut të FTR sipas pure LRIC, njëlloj siç është vepruar me MTR.

Figure 6: EU MTR/FTR differential



Gjithashtu, VA shpreh shqetësimin e saj për sa i përket qasjes së AKEP në të dy analizat e tregut (terminimin fiks dhe mobile) dhe përkatësisht rregullimit të tarifave FTR dhe MTR, ku duket qartazi favorizim i operatorit Altelecom në kundërshtim me çdo praktikë të mirë dhe kuadër rregullator Evropian. Madje, në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare AKEP në mënyrë absurde po konsideron aplikimin e asimetrisë për MTR mbi arsyetimin e ndarjes së tregut midis operatorëve (market share-justifikim i paparashikuar në asnjë udhëzim apo akt rregullator për aplikimin e asimetrisë), ndërkohë në tregun e terminimit në rrjetet fikse ku Altelecom zotëron gjithmonë mbi 70% të pajtimtarëve dhe mbi 85% të thirrjeve, jo vetëm që nuk konsideron aplikimin e asimetrisë, por avantazhon më tej duke shtyrë aplikimin e glide-path për uljet e FTR në nivelet e BE pa një llogaritje të duhur të bazuar mbi kostot e operatorit eficient.

Vodafone mbetet i qëndrimit që simetria e tarifave të terminimit duhet të jetë rregulli, ndërsa aplikimi i asimetrisë në raste përjashtimore është një masë jashtëzakonisht ekstreme dhe duhet të mbështetet nga një justifikim i përshtatshëm mbi diferenca objektive kostosh jashtë kontrollit të operatorëve në shqyrtim. Në të kundërt, tarifatat asimetrike janë tepër të rrezikshme dhe pengojnë konkurrencën e lirë dhe zhvillimin e inovacionit.

VA kundërshton fuqimisht vlerësimin e AKEP se mbajtja e FTR në nivele më të larta do të ndihmojë rritjen e konkurrencës në treg dhe i përshtatet karakteristikave të tregut shqiptar dhe kostove që mbartin operatorët e telefonisë fikse krahasuar me ata celulare. Kostot e rrjetit janë gjithmonë më të larta për operatorët celularë pasi lidhen ngushtësisht me rrjetin e aksesit çka rrjedh në diferencën e madhe në strukturën e kostove mes rrjeteve fiks dhe celulare siç edhe e reflekton praktika e BE.

Në rastin e rrjetit të telefonisë fikse ky është rrjeti i telit të bakrit. Në rastin e telefonisë celulare ky është rrjeti i stacioneve bazë. Telat e bakrit i dedikohen përdoruesve të veçantë dhe nuk përfshihen në kostot e shërbimeve zanore. Kurse stacionet bazë janë infrastrukturë që ndërtohet për një shumicë përdoruesish dhe përfshihen në kostot për shërbimet zanore. Mënyra më e përshtatshme për të shpjeguar sa më lart është nëpërmjet analogjisë: nëse të gjithë pajtimtarët e rrjetit të telefonisë fikse dyfishojnë numrin e thirrjeve/minutave që ata kryejnë, nuk do të ketë investime shtesë në tel bakri. Kundërshtimisht, nëse të gjithë pajtimtarët e rrjetit të telefonisë celulare do të dyfishonin numrin e thirrjeve/minutave të kryera, numri i stacioneve bazë do të rritej në mënyrë të ndjeshme. Nga ana tjetër, përhapja e gjërë e shfrytëzimit të telefonisë celulare në një treg me 3 operatorë rrjeti jo detyrimisht



përkthehet në ulje kostosh për operatorët celularë, pasi avantazhet e ekonomive të shkallës nuk aplikohen si në rastet e tregjeve me kosto të ulëta hyrjeje.

Kjo tregon qartazi se kostot e stacioneve bazë janë të lidhura në mënyrë shkakësore me ofrimin e shërbimeve zanore. Kjo është dhe arsyeja thelbësore se pse regjimet e tarifave të terminimit të orientuara drejt koston gjithmojnë rezultojnë në FTR që janë në mënyrë të ndjeshme më të ulëta se MTR, dhe kurrese si nuk mund të ndodhë e kundërta.

Kjo theksohet gjithashtu edhe në propozimet e Komisionit Evropian për rishikimin e kuadrit rregullator në komunikimet elektronike (ku përfshihet dhe draftimi i një direktive për Kodin e Komunikimeve Elektronike (EEC) që mendohet të jetë plotësisht i zbatueshëm në mes 2019) ku Komisioni planifikon të vendosë tarifë tavan për terminimin si më poshtë:

- 0.14 Eurocent/min për terminim fiks; dhe
- 1.23 Eurocent/min për terminim mobile.

Komisioni Evropian në Rekomandimin e tij të vitit 2009 parashikon më tej në nenin 2 se metodologjia e rekomanduar (e duhur) për të përcaktuar koston e një operatori eficient duhet të bazohet në kostot korrente dhe modelin BULRIC. Në vijim në nenin 4 përcaktohet se modeli i koston duhet të jetë i bazuar në teknologji eficiente të disponueshme gjatë kohës së vlerësimit të modelit. Për këtë qëllim, pjesa qendrore e rrjetit fiks dhe celular duhet të jetë parimisht e bazuar në Next-Generation-Netëork (NGN).

Bazuar në sa më sipër, duke qenë se pjesa qendrore e rrjetit fiks Altelecom është tashmë e bazuar plotësisht në NGN, pra operon me një teknologji eficiente, VA vlerëson se plotësohen kushtet për të kryer një analizë të metodologjisë së koston FTR sipas kostonve të një operatori eficient për operatorët e telefonisë fikse. Në mungesë të kësaj analize, VA gjykon se AKEP do të duhet të përdorë metodën benchmarking duke synuar qasjen me vendet e BE që kanë aplikuar modelin pure LRIC, ashtu siç ka bërë dhe në rastin e MTR.

Direktiva Kuadër 2002/21/EC (Frameëork Directive) parashikon në nenin 16/1 se '*Autoritet Rregullatore Kombëtare, duhet sa më shpejt të jetë e mundur pas adoptimit të një rekomandimi apo përditësimit të tij, të ndër marrin një analizë të tregjeve përkatës duke u përprjekur maksimalisht për zbatimin e këtyre rekomandimeve*'. Edhe Ligji 9918, date 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përcakton qartazi në nenin 7 të tij se AKEP merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC.

AKEP duhet të mbështetet në kuadrin rregullator dhe praktikën e vendeve të BE dhe të garantojë trajtimin jodiskriminues dhe me të njëjtin standard të MTR përkundrejt FTR. Nga ana tjetër siç edhe praktika por edhe teoria ekonomike ka treguar, përafrimi i FTR me koston e operatorit eficient do të rezultojë në rritjen e konkurrencës, eliminimin e ineffiçencave në treg, duke nxitur operatorët në treg për të qenë më inovativë dhe eficientë, çka do të reflektohet dhe në ulje të tarifave për pajtimtarët fundorë.

Në përfundim, VA e dënon një qasje të tillë të njëanshme të AKEP, ku ky i fundit, duke zbatuar një standard të dyfishtë krahasuar me analizën e tregut celular (por me të njëjtin qëllim që në mënyrë arbitrare të vendosë në pozicion të favorshëm Altelecom - operator monopol në infrastrukturën e rrjetit fiks në nivel kombëtar) ka riparë përshkallëzimin dhe ka shtyre uljen e FTR me një vit tjetër pa ndonjë llogaritje të bazuar në kosto sipas Rekomandimit të Komisionit Evropian. Nuk mund të theksojmë sa duhet faktin se AKEP, si organ rregullator, duhet të jetë i paanshëm në qasjen dhe trajtimin e tij ndaj të gjithë lojtarëve

në treg dhe qëllimi i tij duhet të jetë promovimi i konkurrencës së ndershme në tregun e komunikimeve elektronike. Është e papranueshme që AKEP të zbatojë standarde të dyfishta duke favorizuar Albtelecom dhe duke diskriminuar lojtarët e tjerë në tregjet fikse dhe celulare, duke shkelur haptazi parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabarte midis operatorëve siç përcaktohet qartazi në kuadrin ligjor në fuqi të Shqipërisë dhe BE.

Këto qasje të paarsyeshme ndaj të dyja tregjeve në favor të Albtelecom, shkelin detyrimet themelore ligjore dhe konsiderohen si diskriminuese dhe kërcënojnë konkurrencën, në vend që ta ndihmojnë atë. Zbatimi i këtyre masave duke favorizuar qartazi njëren palë konsiderohet si ndihmë shtetërore dhe është një praktikë e ndaluar nga parashikimet e kuadrit ligjor vendas dhe atij evropian.

### Albtelecom

Siç kemi parashtruar që në hyrje të komenteve tona, ritheksojmë edhe njëherë si me poshtë:

Lidhur me skemën e propozuar nga AKEP për reduktimin e tarifave të terminimit (FTR-së) në rrjetet fikse dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom, gjujkojmë se nuk është e justifikuar dhe nuk mbështetet për arsye thelbësore të kushteve dhe rrethanave të telefonisë fikse në Shqipëri, pjesë të konsiderueshme të të cilave janë të evidentuara lehtësisht edhe përgjatë dokumentit të Analizës së AKEP, si më poshtë:

- Efekti zëvendësues në rritje i shërbimeve të telefonisë fikse me shërbime nga rrjetet celulare që ka çuar në tkurrjen e sektorit të telefonisë fikse dhe treguesve kryesorë të tij përsa i takon numrit të abonenteve, trafikut të interkoneksionit, të ardhurave, normës së penetrimit, etj.

Vlen të theksojmë se, edhe për thirrje brenda rrjetit të ofruara falas nga pjesa më e madhe e operatorëve të telefonisë fikse, nuk ekziston as nxitja minimale e abonentit për të kryer thirrje me abonentë të tjerë të telefonisë fikse, ndërkohë që ofertat në minuta të operatorëve celularë janë me bollëk. Për rrjedhojë, nëse rënia e numrit të abonentëve të telefonisë fikse për vitin 2017 është 3% krahasuar me Vitin 2016, trafiku i Albtelecom i thirrjeve brenda rrjetit dhe i të gjithë thirrjeve dalëse drejt destinacioneve të tjera është reduktuar më shumë se 20% për vitin 2017, në disproporcion të theksuar me rënieën e numrit të abonentëve.

- Ulja e konsiderueshme e trafikut të terminuar në rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse, si rrjedhojë edhe e përdorimit në masë të aplikacioneve të tillë si ËhatsApp, Viber, dhe Messenger, etj, ç'ka impakton direkt të ardhurat e operatorëve nga trafiku telefonik.
- Trendi gjithnjë zbritës i të ardhurave të operatorëve të telefonisë fikse, të cilat për Albtelecom në veçanti janë reduktuar me rreth 15% për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, ndërkohë që investimet tona në rrjetin dhe infrastrukturën e telefonisë fikse kanë vijuar në rritje si një domosdoshmëri për t'i siguruar dhe sjellë abonentit shërbim më të mirë (rritja e investimeve për vitin 2016 rreth 62% krahasuar me vitin 2015).
- Vështirësia dhe pamundësia për përfitimin nga ekonomitë e shkallës si për operatorët alternativë, ashtu dhe për vetë Albtelecom për shkak të ekzistencës së një numri të madh operatorësh, që shërbejnë edhe lokalisht dhe me madhësi të kufizuar të rrjetit, të numrit të vogël të popullsisë së shërbyer, efektit zëvendësues të telefonisë celulare, etj.

- Normë penetrimi shumë të ulët dhe në rënie vit pas viti krahasuar me çdo vend tjetër të EU-së apo Rajonit, si dhe trend zbritës në numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse prej vitit 2015 e në vazhdim.

Por gjithashtu, jo më pak të rëndësishme dhe me ndikim të ndjeshëm në gjendjen financiare të Albtelecom, si:

- Informaliteti i mundshëm në tregun e komunikimeve elektronike e adresuar nga Albtelecom edhe me shkresë zyrtare pranë AKEP mbi operimin e mundshëm në rrugë informale të operatorëve, çka shkakton konkurrencë të pandershme duke i dhënë mundësinë operatorëve informale për gjenerimin e të ardhurave në mënyrë të padrejtë dhe uljen e të ardhurave për Albtelecom, i cili nga ana e tij përmbush me korrektësi detyrimet ligjore dhe rregullatore.
- Ngarkesat e vazhdueshme dhe të padrejta ndaj Albtelecom nga thellimi i aplikimit të taksave në mënyrë jo proporcionale nga njësitë e ndryshme vendore të paktën që prej vitit 2011 mbi infrastrukturën e telefonisë fikse e cila rrit kostot dhe shpenzimet dhe përkeqëson gjendjen financiare të Albtelecom.
- Dëmtime të vazhdueshme nga të tretët në infrastrukturën e rrjetit të cilat Albtelecom detyrohet në shumicën e rasteve të rikuperojë me kostot e veta. Edhe ky faktor ndikon ndjeshëm në kostot dhe shpenzimet e Albtelecom dhe përkeqëson gjendjen financiare të tij.

Pikërisht, duke konsideruar si shumë të rëndësishme kushtet dhe rrethanat e mësipërme aspak të krahasueshme me vendet e tjera të EU-së apo rajonit, karakteristikat e këtij tregu në Shqipëri, është më se e qartë dhe e arsyeshme që tarifat e terminimit dhe të tranzitimit jo vetëm të mos reduktohen, por përkundrazi të rriten arsyeshmërisht që t'i shërbejë edhe nxitjes së investimeve në rrjetin fiks, pjesë e të cilit është edhe broadband. Kjo, për më tepër që tarifat e terminimit të operatorëve të këtij tregu dhe i tarifës së tranzitimit të Albtelecom nuk kanë patur prej kohësh dhe nuk kanë aspak ndikim në tarifimin e thirrjeve me pakicë dhe më tej akoma në vendimin final të abonentit për të kryer thirrje nga rrjeti fiks, sa kohë që edhe thirrjet e ofruara falas (brenda pagesës mujore) nga operatorët alternativë dhe Albtelecom kanë përdorim shumë të vogël, dhe vijueshmërisht në ulje prej vetë abonentëve.

Nga referimi në vendet e EU-së, është i evidentueshëm lehtësisht rasti i veçantë i Polonisë, ku në dallim nga gjithë vendet e tjera të këtij grupi mban tarifën e terminimit prej rreth 1.51 Lekë/min. Ne besojmë që janë pikërisht specifikat dhe rrethanat e veçanta në Poloni për të cilat Autoriteti Rregullator i Polonisë i ka konsideruar dhe ka përcaktuar mbajtjen e kësaj tarife terminimi, që është krejtësisht e ndryshme nga tarifa e terminimit benchmark e vendeve të tjera.

Prandaj, Albtelecom gjykon se reduktimi i propozuar i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse si dhe i tarifës së tranzitimit nga 01.09.2018 në 1 lek/min dhe 0.63 lek/min respektivisht, dhe reduktimi i mëtejshëm i propozuar nga 01.01.2019, jo vetëm që është i pajustificuar, por vetëm sa çon në mënyrë të pashmangshme në uljen e mëtejshme të të ardhurave të operatorëve në telefoninë fikse dhe rrjedhimisht edhe në ulje të stimulit për rritje të investimeve të tyre në rrjetet fikse, dhe duke mos patur anjë përfitim për përdoruesin fundor/abonentin.

Kështu, megjithë përpjekjen për të mirëkuptuar qasjen e AKEP për reduktimin e kostos së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, por nga ana tjetër:

- në kushtet dhe rrethanat renditur më lart, që kanë çuar vetëm në rënien e vazhdueshme të të ardhurave të operatorëve të telefonisë fikse, si dhe;
- bazuar në mos ndikueshmërinë prej kohësh tashmë të nivelit të tarifës së terminimit apo tranzitimit në përfitimet e mëtejshme të përdoruesit fundor/abonentit;
- ekzistencën e të paktën një praktike në EU të tarifës së terminimit të dalluar nga vendet e tjera të grupit të EU-së.

Albtelecom gjykon si të domosdoshme dhe kërkon nga AKEP vendosjen e tarifës së terminimit prej 1.51 lekë/min dhe 1lekë/min të tranzitimit të paktën deri në analizën tjetër të radhës të tregut të telefonisë fikse.

Në çdo rast që AKEP mund të gjykojë ndryshe, atëherë çdo lloj përcaktimi i ktyre tarifave duhet të jetë racional dhe i justifikuar me qëllim që të shërbejë konkretisht për përfitueshmërinë e përdoruesit fundor dhe për nxitjen e investimeve në rrjetet fikse dhe jo të rezultojë thjesht në tkurrje të vazhdueshme të të ardhurave të Albtelecom apo dhe të gjithë operatorëve të telefonisë fikse. Në këtë kontekst, ritheksojmë edhe njëherë se çdo lloj reduktimi i FTR-së para vitit 2019 dhe përshkallëzimi i mëtejshëm gjatë vitit 2019, për më tepër në masat respektive 23% dhe 30% të propozuar nga AKEP, në gjykimin e Albtelecom është krejtësisht i pajustificuar dhe i papranueshëm, dhe siç e theksuam edhe më lart, vetëm sa redukton të ardhurat e operatorëve dhe nuk shërben për asnjë përfitim tjetër në tregun e komunikimeve elektronike.

*Propozimi i Albtelecom është për vendosjen e tarifës 1.51 lekë/min të terminimit dhe 1 lekë/min të tranzitimit të paktën deri në analizën e radhës së tregut të telefonisë fikse (tabela më poshtë):*

	01.01.2016	01.01.2017	01.01.2018 - (deri në një vendim tjetër të AKEP)
Albtelecom terminim:			
Njëfish (kombëtar)	1.48	1.29	1.51
Albtelecom transit kombëtar	0.93	0.81	1
Operatorët Alternativë	1.48	1.29	1.51
Telekom Albania	1.48	1.29	1.51

Shënim: Tarifat janë pa TVSH

### Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me FTR, AKEP po në këtë dokument ka propozuar edhe glide path-in i cili në një të ardhme të afërt po shkon drejt simetrisë të tarifave të këtyre rrjeteve, fakt ky i cili, veç të tjerash, do të promovojë shërbimet nga fiksi dhe ndikon direkt në zëvendësueshmërinë midis fiksit dhe celularit. Simetria midis dy rrjeteve është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e tregut përkatës me pakicë të shërbimeve telefonike nga vendndodhje fikse i cili përfshin:

**aksesin dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse të ofruara nga operatorët e rrjeteve fikse dhe aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare.**

Dy janë shqetësimet kryesore në komentet e TA, 1) futja e një periudhe ndërmjetëse 1.09.2018-31.12.2018 për aplikimin e FTR 1 lekë/min dhe të tarifës së tranzitit kombëtar 0.63 lekë/min në rrjetin e Albtelekom, dhe 2) tarifat nuk janë të mbështetura dhe të orientuara në kostot përkatëse për përllogaritjet e tyre.

AKEP sqaron se të dyja këto elementë janë bërë duke u bazuar në tarifat mesatare të vendeve të BEREC, si një praktikë e ndjekur vazhdimisht në të gjitha analizat e mëparshme si dhe nga mungesa e informacionit rregullator të kostove të shërbimeve të interkoneksionit të operatorëve.

Gjithashtu nga llogaritjet që janë bërë dhe janë argumentuar më sipër në dokumentin e Analizës, propozimi i tarifave të terminimit e tranzitimit dhe periudhat e reduktimit të tyre ruajnë nivelin mesatar të të ardhurave të terminimit në rrjetin fikse në vendet e BEREC.

Nga komentet e Albtelecom veçohet fakti se ai kërkon nga AKEP vendosjen e tarifës së terminimit prej 1.51 Lekë/min dhe 1 lekë/min të tranzitimit të paktën deri në analizën tjetër të radhës të tregut të telefonisë fikse. Tarifat që propozon Albtelecom janë shumë më të larta se ato që janë propozuar në dokument, madje më të larta se tarifat përkatëse që janë aplikuar që në dt.1.1.2016 (përkatësisht 1.48 lek/min dhe 0.93 lekë/min).

AKEP, gjykon se niveli i propozuar në dokumentin e Analizës është në një proporcion të drejtë për të gjithë operatorët e rrjetit fikse, duke theksuar edhe faktin se Albtelecom është operatori i shpallur FNT në tregun e tranzitimit kombëtar, çka do të thotë se ka peshën më të madhe në këtë treg, shtrirjen më të madhe gjeografike e si rrjedhojë edhe pjesën më të madhe të të ardhurave.

Lidhur me propozimin e Vodafone për zbatimin e LRIC të paster, AKEP sqaron se rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar (glide path), kjo është një praktikë e ndjekur nga AKEP me transparencë në raundet paraardhëse të analizës së tregjeve përkatëse dhe është në përputhje me parashikimet e ligjit 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

Reduktimet e propozuara të tarifave të terminimit nga data 1.9.2017 janë 23 % ndërsa duke filluar nga data 1.1.2019 variojnë nga 40-45% për tarifat e terminimit të thirrjeve në lek/minutë.

Tarifa e propozuar për terminim në rrjete fikse në Janar 2019 (0.7 lek/minutë) është sa tarifa mesatare e vendeve të BE (BEREC), por më e lartë se tarifa mesatare benchmark sipas LRIC të pastër në rrjete fikse (0.14 eurocen ose 0.182 lek/minutë sipas kursit zyrtar të BSH datë 30.3.2018 1 eur=130 lek) e aplikuar në vende të BE.

Edhe në analizën paraardhëse të tregut me shumicë të terminimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse AKEP ka sqaruar se karakteristikat e tregut fikse në Shqipëri:

- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE.
- këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke çuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri për rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;

- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjetet fikse, jo vetëm për telefoni fikse, por sidomos për akses broadband fikse.

**Gjithsesi, diskutimi për metodën e rregullimit të FTR nëpërmjet dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendodhje fikse –Këshillim Publik” do të nxirret për këshillim publik 30 ditor sipas nenit 57 të ligjit 9918 “Për komunikimet elektronike në RSH”, në linjë dhe me praktikatat e fundit të ndjekura nga AKEP për analizat e tregut dhe metodën e rregullimit të tarifave për sipërmarrësit me FNT.**

-----\*\*\*\*\*-----

---